Mundohuni t'i mësoni birit tim forcën për të mos e ndjekur turmën edhe kur të gjithë të rendin pas fitimtarit. Mësojeni të dëgjojë me vëmendje çdo njeri, por gjithashtu të shoshisë të gjithë atë që dëgjon në sitën e së vërtetës dhe të marrë vetëm të mirën.

Mësojeni atë sesi të shesë talentin dhe zgjuarsinë e tij tek ofertuesi më i lartë, por mos të pranojë kurrë asnjë soj çmimi për shpirtin e zemrën. Lejojeni atë të këtë kurajo për të qenë i adhurueshëm. Lejojeni atë të këtë durimin për të qenë trim. Mësojeni atë të këtë besim sublim tek vetvetja, sepse atëherë ai do të këtë gjithmonë besim sublim në njerëzimin dhe në Zotin.

Këto janë kërkesat, mësues, por ju bëni më të mirën që mundeni. Ai është një fëmijë i vogël kaq i mirë dhe është im bir.

Hapat e parë drejt një jete të re Mës. Ardita Gashi



Një shtatori erdhi me emocionet e më të vegjëleve për t'u takuar me shokët e ardhshëm dhe mësuesen e parë në jetën e tyre. Duket se edhe të rriturit nuk mund të mungojnë në këtë festë të madhe, sepse që të gjithë duan të dëshmojnë këtë hap të madh në jetën e vogëlushëve. Me buzëqeshjen rrëzëlluese dhe buqetat e luleve nëpër duar, me ndjesinë e përzier të gëzimit dhe të frikës, të veshur dhe të krehur me kujdes, të gjithë dukeshin të bukur dhe të këndshëm.

Në fillim kishin pak emocione, rrinin në heshtje, ashtu të kapur për dore me të rriturit, sikur donin të siguroheshin se gjithçka do të shkonte në rregull, por, shumë shpejt, në shkëmbimet me shokë të rinj, filluan ta ndiejnë botën e re që po ju shpërfaqej përpara. Recituan vjersha dhe rrëfyen emocionet e tyre. Syçkat e tyre filluan të shkëlqejnë nga gëzimi dhe me kuriozitet filluan të shfletojnë faqet e para. Është e magjishme si fëmijët gjithnjë të japin buzëqeshje për të ta bërë ditën më të mirë.

Ndjesitë e bukura të kësaj dite të rëndësishme i përjetova edhe unë. Nxënësit u shkëputën nga dora e mamit dhe e babit dhe u bashkuan me dorën e mësueses, për të vazhduar rrugën e gjatë dhe të bukur të dijes. Më mallëngjeu gjithçka që merrte frymë në atë klasë, e ndieja peshën dhe rëndësinë e misionit tim: t'ua mësoj fëmijëve shkronjat dhe numrat, që të mos këndohen më vargjet e poemës së Nolit "pranë dijes i panxënë". Shkolla me të vërtetë ishte e shkëlqyeshme. Kolegët ishin shumë miqësor dhe mikëpritës, të gatshëm të më mbështesin kurdo që unë kam nevojë.


Ndihem shumë e entuziazmuar me angazhimin tim në shkollën fillore "Loyola", sepse jam bindur se është një shkollë me standarde të larta arsimore dhe që u ofron nxënësve mundësi për zhvillim përtej horizonteve të rëndomta për shoqërinë tonë: duke kërkuar vazhdimisht përsosmëri akademike, duke përdorur teknologji të ndryshme si mjete mësimi, me qëllim të maksimizimit të performancës individuale të studentëve, duke e frymëzuar interesin e nxënësve për t'u vetëvlerësuar në mesin e të gjithë nxënësve tjerë. Prandaj edhe do të punoj me përkushtim të madh që përmes realizimit të planprogramit mësimor, të arrij të siguroj cilësi në mësim tek nxënësit duke u dhënë njohuritë e mia në mënyrë të qartë dhe të saktë.

Nga vullneti dhe entuziazmi ynë si staf i shkollës varet suksesi i rezultatit në mësimdhënie. Pra synimi ynë final për vitin e ri shkollor, është një mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore.

Shkolla fillore "Loyola" - shkollë cilësore Mës. Shukrije Krasniqi

Një ndër treguesit më relevant të shkallës së zhvillimit dhe civilizimit të një shoqërie, apo komuniteti, është edukimi dhe arsimimi. Shoqëria është e përfshirë në një proces të shpejtë ndryshimi. Edhe ne, si pjesëtarë të saj, duhet të ndysojmë, sepse ka ndryshuar kahu i zhvillimit të shoqërisë, rrjedhave e kërkesave të reja ku nuk mund t'u përgjigjemi me konceptet e praktikën e kaluara, pra ka ndryshuar pikësynimi i shkollës. Në shkollën fillore "Loyola", janë krijuar kushte shumë të favorshme për të bërë shumë më shumë për këtë objekt. Rëndësia dhe roli i edukimit, arsimit dhe të nxënësve për shoqërinë njerëzore, në këtë shkollë kanë një vlerë gjithnjë e më të madhe.

Ç' mund të ishte më e keqe se verbëria e trashëguar ... të kesh sy e të mos kesh vizion. (Hellen Keller)



Një vizion të qartë për të ardhmen, në këtë proces shumë të rëndësishëm e gjeta në ALG. Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, e realizon shkolla "Loyola" e cila ka ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit. Në shkollën tonë vazhdimisht ndërmerren reforma për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor, ku synohet përgatitja e qytetarit evropian të aftë dhe të shkathtë, ku si për bazë merret parimi demokratik për mundësi dhe motivim të barabartë për të gjithë individët, pavarësisht gjuhës, racës, gjinisë, ngjyrës, fesë dhe kombit.

Karakteristikë e kësaj shkolle është zhvillimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore dhe teknike- teknologjike, sistemi i mirfilltë dhe disiplina për punë, me të vetmin qëllim, ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor. Si e tillë, me idetë inovative është bërë shëmbull i përvojës së përparuar si në vend dhe në rajon, duke ndikuar në zhvillimin e shkathtësive për përdorimin e teknologjive të reja, në funksion të mësimdhënies dhe mësim-



nxënies moderne.

Përvoja ime shumëvjeçare në procesin e mësimdhënies më ka bërë të kuptoj shumë gjëra dhe përvoja të reja. Në vitet e para të punës sime, të nxënësve si proces ishte shumë tradicional. Burim i mësimi ishte mësimdhënësi dhe libri, më shumë rëndësi i kushtohej teorisë. Mësimdhënësi ishte në qendër të vëmendjes, ndërsa nxënësit reflektonin për momentin, por pas pak kohe ato njohuri harroreshin ngase ishin mësuar mekanikisht. Të gjitha këto tani kanë kaluar, sepse sot kemi një mësimdhënie bashkëkohore, ku nxënësi është në qendër të vëmendjes. Sot, mësuesi udhëheq nxënësin për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe më ndihmën e tij, përgatit nxënësin që të përballë me çdo sfidë të jetës, sado e ndërlikuar që të jetë ajo. *"Njerëzit çmohen jo për atë çka dinë, por për atë çka bëjnë me atë që dinë."*

Në këtë shkollë është e lehtë t'i vëmë në jetë ato që dimë. "Loyola" është shkollë cilësore, ku u ofrojmë nxënësve edukim dhe arsimim bashkëkohor, ku rrugëtojmë drejt arritjeve më të reja, ku ecim me kohën për një të ardhme më të lumtur e më të begatshme. Këtu krijojmë gjenerata të shëndosha dhe të afta, që të kontribuojnë në zhvillimin e shtetit të Kosovës dhe të shoqërisë në përgjithësi dhe që të jenë të gatshëm për tregun global të punës.

Të gjithë e dinë se *"suksesi shihet përmes ndryshimeve pozitive dhe performanca matet me rezultat"* e këto janë vlera që i hasim në këtë shkollë. "Mësimdhënia ime në këtë shkollë po më jep kënaqësitë e të përcjellurit të vlerave të së bukurës edhe universalitetit që i duhen të rinjve për t'u formuar. Me pasionin që kam për punën fisnike të mësueses, me dëshirën për të përçar tek nxënësit jo vetëm dije, por dhe kulturë e edukatë, ndjehem e nderuar që punoj në këtë shkollë.

Përfundimisht për të treguar se sa i rëndësishëm është arsimit për njeriun do ta përmbylli me thënien e Heraklitit: *"Arsimi është dielli i dytë për njeriun."*



Fëmijët të japin forcë në misionin e shenjtë të mësuesit Mës. Zana Susuri



Zemra më rrihte fort, gjersa shpejtoja drejt godinës blu. Nuk ishte vizitë e zakonshme kur më mernin kushërinjtë e mi të vegjël në "Ditën e dyerve të hapura", të cilët me plot krenari donin të ma tregonin shkollën e tyre dhe çdo gjë lidhur me të. Këtë herë ishte ndryshe. Ecja drejt godinës së madhe blu me një shqetësim të madh dhe me frikë, me mendimin se nuk do t'ia dal dot.

Intervistë! Unë pjesë e kësaj godine, e një sistemi të ri për mua, të cilin nuk mendoja se do t'i përkas. Aq afër e aq larg më dukej, nuk kisha besim se do t'ia dilja. Çka do të më pyesin, si do të sillem, a mund të jem e denjë për një sistem të tillë shkollor? Jo, nuk besoja se do ta kem fatin e madh.

Unë ia dola, kjo është kryesorja dhe kjo frikë tani më duket larg. Por, tani më lind frikë tjetër që ndërlihet me një dëshirë shumë të madhe: Të dëshmoj se unë jam për vendin tim, në godinën e madhe blu, që jam e denjë për të qenë pjesë e sistemit shkollor i cili duhet të jetë shembull për shkollat tjera dhe për tërë venid tim. Unë duhet të punoj për këtë që ky sistem të përqafohet nga të gjithë, me rregullin, punën dhe përkushtimin që e ka.

E kam një ushtri të vogël nën përgjegjësinë time, 22 koka të vogla, që kthejnë shikimet e tyre plot jetë e kureshtje nga unë dhe më shikojnë, më bëjnë qindra pyetje dhe e ndiej se presin përgjigjet që do t'ua ndriçojnë orën e tyre të mësimit dhe të fatit. Unë jam me ta nje qenie e vetme, e cila ka plot sfida përpara në rrugën drejt suksesit dhe ndriçimit të tyre.

I dua shumë, i ndiej dhe mendoj se kjo është forcë që më jep fuqi në realizimin e detyrës sime të shenjtë: t'ua mësoj shkronjat e para dhe t'u flas për çdo gjë që i rrethon. T'i ndihmoj të rriten, siç meriton çdo fëmijë në botë.



Ditëlindja e Irisit Mës. Agnesa Çipa-Laçi



Ftesa ishte e mirëseardhur, ngase përputhej me programin tonë për një ditë shëtitjeje në shtator. Iris Vata nx. e kl. IIa e kishte ditëlindjen. Prindërit e saj na ftuan për kremtim në shtëpinë malore. Të gjithë fëmijët këtë ditë e prisnin me gëzim. Më 19.09.2014, që në orën tetë, u nisëm nga shkolla. Pas gjysmë ore arritëm në fshat. Na thanë se një copë rruge duhej ta bënim në këmbë. U nisëm në rresht. Nxënësit bisedonin e qeshnin. Zërat e tyre kumbonin si zile në freskinë e mëngjesit. Teksa ecnim tatëpjetës së fshatit, era e dheut, e gjelbërimit dhe ajrit të pasur me oksigjen, na i mbushi mushkëritë. Një erë e lehtë i lëkundi degët dhe mbi gjethe u shfaq dielli i buzëqeshur, duke na e shkelur syrin: Oh, ç' mrekulli!

Papritur, fëmijët që ishin më përpara, u tubuan rreth diçkaje. Ishte një qen leshverdhë që ishte ulur në këmbët e pasme dhe sikur po na dëshironte mirëseardhje. Pas pak, nëpër ajër, dëgjuam se po shpërndaheshin tingujt e këngëve shkollore dhe ja, arritëm. Te porta e shtëpisë na pritën prindërit e buzëqeshur të Irisit, dy gjyshe dhe dy gjyshër, Darisi i vëll, daja dhe nusja e tij. Na pritën me gëzim e përzemërsi. Para nesh, së shpejti u shfaq edhe Irisi, më e bukur se çdo herë. Me një fustan ngjyrë vjollce dukej pors i një lule në pranverë. Atë e shoqëronte një vajzë e madhe e veshur si Borëbardha e me dukje të Barbit, si e karakterizuan vajzat menjëherë. Ishte kjo një shoqëruese aktive e fëmijëve gjatë gjithë kohës.

U tubuam rreth tryezës së pasur me ushqime dhe lëngje dhe ia nisëm kremtimit me legjendën mbi emrin e lules Iris Ilirikum që daton qysh nga koha e mbretërshës Teutë, të cilën nxënësit e dëgjonin me vëmendje teksa u rrëfeja. Pastaj fëmijët u shpërndanë duke ngrënë ushqime të shijshme. Pasuan vallet ritmike muzikore, këngët, vrapi i djemve pas qenit leshverdhë, Xhejit dhe atij të ziut, Zeusit.

Kopshti i bukur i shtëpisë madhështore gumëzhinte nga festa e fëmijëve. Erdhi çasti kulmor i ditëlindjes. U këndua kënga, u pre torta me qirinj e fishekzjarrë, dhurimi i dhuratave, e më vonë edhe garat me litar e me balona. Po atë ditë edhe Erioni i IIb kishte ditëlindjen. Edhe atij ia kënduam këngën, duke i dëshiruar jetë të gjatë dhe të lumtur. Askush nuk mbeti pa marrë pjesë aktivisht në festën e Irisit. Borëbardha printe vazhdimisht, por edhe ne mësueset dhe disa nëna të nxënësve që ishin me ne, e shijuan këtë gëzim të fëmijëve.

Së shpejti u dëgjua zëri i xhaxhit shofer, i cili tha se po nisët i pari për ta kthyer autobusin. Kishim aq kohë sa për t'u përshëndetur me nikoqirët tanë. U nisem teposhtëzës së fshatit, duke tundur duart në ajër në shenjë përshëndetjeje, me një shije të theksuar kënaqësie nga një festë e mrekullueshme ditëlindjeje.

Qeni leshverdhë na përcillte me kujdes, me vështrimin mirënjohës nga bregu ...

Ku është çelësi i suksesit në shkollën "Loyola"? Mës. Agnesa Çipa-Laçi

Në takimin e parë me drejtorin e shkollës, më kujtohet shumë mirë se më tha se dera e zyrës së tij është gjithmonë e hapur, jo vetëm sa për të thënë, por edhe fizikisht. Shumë shpejt na dha një shumë parash dhe na tha t'i pajisim klasat me të gjitha mjetet ndihmëse për mësim të klasës së parë, duke shtuar që të mos kuresejmë asgjë që është në dobi të mësimdhënies cilësore. Këta, populli ynë i quan zemërgjerë, mendjendritur dhe dorëhpaur. Pasi befasia e radhës. Në ditën që nënshkruam kontratën, na pajisi me nga dy çelësa: të oborrit të shkollës dhe të shkollës. Kah fundi i pushimeve verore, para se t'ia nisnim punës në shkollës fillore, bëmë një ekskursion. Na thanë se shkuarja ishte e domosdoshme. U bindëm. Me kolegen u njohëm nga shumë aspekte, si është më së miri: Gjeta motrën binjake të profesionit. Në mbledhjen e parë të këshillit të arsimtarëve dëgjova për "Vjetarin" që ishte gjë përsëri e re për mua, që kisha punuar 24 vjet në shkollën publike.

Viti shkollor filloi me të gjitha përgatitjet, pa u lënë hapësirë befasive të pakëndshme që mund të prishin gjë. Filluam punën plot zell dhe suksese, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me prindërit dhe nxënës të zellshëm e shumë të shkathët. Dhe, sa herë që shkonim në administratë, dyert vërtet i gjenim të hapura. Kryenim punë dhe vazhdonim punët tjera. Dyert pas nesh i linim të hapura, ashtu si i gjenim. Po përgatitnim "Festën e Abetares", që do të përputhej me Ditën e Shkollës dhe përsëri një gjë e re për një mësimdhënëse të shkollës publike prej një çerek shekulli: Dita e Shkollës quhej "Dyert e hapura"! E përjetuam edhe këtë dhe zemrat tona hapeshin gjithnjë e më shumë ndaj këtij tempulli të dijes. Shumë kush më ka pyetur se a po mund të përshtatem në rrethana të reja? A kam shumë punë? Po përgjegjësi? Punë kam bërë gjithnjë, por dallimi është se këtu puna vërehet, ruhet dhe vlerësohet. Rrethanat e reja janë se çdo gjë është në funksion të punës: mjetet, pastërtia, rregulli, ambientet e ngrohta gjatë dimrit. E, kur të gjitha këto kurorizohen edhe me besimin në punën që bën, përgjegjësia mund të jetë vetëm një përgjigje e thjeshtë.

Teksa po e përfundoja këtë shkrim, m'u kujtua se gjatë gjithë vitit kam punuar me derë të hapur të klasës.



"Loyola" - shkollë për nxënës e jo nxënës për shkollë Mës. Shukrije Krasniqi

Zhvillimi i vullshëm i shoqërisë globale, si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit, e ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit të komunikimit, kanë bërë të mundur që të mësuarit të ndryshojë nga vitet e mëparshme, njëkohësisht rëndësia dhe roli i edukimit, arsimit dhe të nxënës për shoqërinë njerëzore kanë marrë një vlerë gjithnjë e më të madhe. Një ndër treguesit më relevant të shkollës së zhvillimit dhe civilizimit të një shoqërie apo komuniteti është edukim dhe arsimit. Shoqëria është e përfshirë në një proces të shpejtë ndryshimi. Edhe ne, si pjesëtarë të saj, duhet të ndryshojmë, sepse ka ndryshuar kahu i zhvillimit të shoqërisë, rrjedhave e kërkesave të reja, ku nuk mund t'u përgjigjemi me konceptet e praktikave të kaluara, pra ka ndryshuar pikësnyimi i shkollës.

Duke falënderuar zhvillimin e vetëdijes shoqërore, janë krijuar parakushte shumë më të favorshme për të bërë shumë më shumë për këtë objektiv.

Çështja e të mësuarit, mënyra e mësimdhënies, mësimnxënies, metodave të nxënës nga përvoja dhe ndryshimet në arsim kanë qenë ndër çështjet të cilat i kanë preokupuar dhe vazhdojnë t'i preokupojnë shumë mësimdhënës dhe ekspertë të ndryshëm të arsimit nëpër botë.

Një praktikë të tillë dhe vizion të qartë për të ardhmen, në këtë proces shumë të rëndësishëm e gjeta në Loyola-Gymnasium. Në këtë shkollë janë zhvilluar dhe ngritur kapacitetet njerëzore dhe teknike-teknologjike me të vetmin qëllim, ngritjen e cilësisë së procesit edukativ.



tivo-arsimor. Si e tillë me idetë inovative është bërë shembull i përvojës së përparuar, duke ndikuar në zhvillimin e shkaktësive për përdorimin e teknologjive të reja në funksion të mësimdhënies dhe nxënies moderne.

Përvoja ime shumëvjeçare në procesin e mësimdhënies më ka bërë të kuptoj shumë gjëra dhe përvoja të reja. Në vitet e para të punës sime, të nxënës si proces ishte shumë tradicional. Burim i mësimi ishte mësimdhënësi dhe libri, më shumë rëndësi i kushtohej teorisë. Mësimdhënësi ishte në qendër të vëmendjes, ndërsa nxënësit reflektonin për momentin, por pas pak kohe ato njohuri harroheshin ngase ishin mësuar mekanikisht. Të gjitha këto tani kanë kaluar, sepse sot kemi një mësimdhënie bashkëkohore, ku nxënësi është në qendër të vëmendjes. Sot, mësuesi udhëheq nxënësin për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe më ndihmën e tij, përgatit nxënësin që të përballlet me çdo sfidë të jetës, sado e ndërlikuar që të jetë.

Lirisht mund të konstatoj se në "Loyola" kemi shkollë për nxënë, e jo nxënës për shkollë. Mësimdhënien në këtë shkollë e aktualizojnë kushtet dhe teknologjia mësimore bashkëkohore e cila rrit efikasitetin dhe racionalizimin në mësim.

Me pasionin që kam për punën fisnike të mësueses, me dëshirën për të përçuar tek nxënësit jo vetëm dije, por dhe kulturë e edukatë, ndihem e nderuar që punoj në këtë shkollë.



Ademaj, Rita
 Aliaj, Ed
 Bytyçi, Driada
 Bytyçi, Julian
 Curi, Mark
 Gashi, Auron
 Gorani, Yllza
 Hajrullaga, Gert
 Hoxha, Lis
 Kqira, Tone
 Kryeziu, Alp
 Kurtaj, Ron
 Marki, Martin
 Muçaj, Emira
 Pireci, Erzen
 Qabrat, Greta
 Shala, Fidan
 Sylejmani, Dea
 Tytynxhiu, Embla
 Vata, Iris

Klassenlehrerin –
 Kujdestarja e klasës:
 Agnesa Çipa-Laçi



Berisha, Elma
 Beshi, Linor
 Bytyçi, Ilda
 Bytyçi, Butrint
 Elshani, Donat
 Gjini, Aron
 Hajdari, Elvis
 Hajdari, Qamil
 Haliti, Arlind
 Haliti, Hana
 Jahaj, Vlerona
 Krasniqi, Sara
 Lumezi, Valentina
 Morina, Jetmir
 Muçaj, Kaltrina
 Nrecaj, Andi
 Qovanaj, Erion
 Tejeksi, Mjellma
 Xhonlleshi, Marsel
 Zogaj, Agon

Klassenlehrerin –
 Kujdestarja e klasës:
 Shukrije Krasniqi





Rëndësia e sentencave latine në tekstet shkollore të latinishtes

Prof. Ramadan Ramadani

Se fjalët e urta përdoren që në kohë të lashta, tregon fakti se i shënonin në hyrje të derës së shtëpisë dhe në mure të dhomave. Kjo traditë u përcoll një kohë të gjatë, ndërsa edhe në ditët e sotme hasen shkrime të tilla ku u dëshirohet mirëseardhje mysafirëve etj. Pothuajse s'ka libër që botohet e të mos ketë si moto ndonjë sentencë. Që në fillim të librit vërehet pesha e rëndë e tyre dhe vlera. Sentencat, me pak fjalë, tregojnë shumë.

Përdorimi i proverbave në libra shkollorë është i lidhur ngushtë me njësinë mësimore që ndodhet në tekst. Në mësimet ku shpjegohet gramatika, pasojnë sentencat në të cilat përdoret koha e cila u është shpjeguar nxënësve. Në tekstet me tregime dhe anekdota hasen sentenca që e zbukurojnë dhe i japin ngjyrë të bukur anekdotës.



Përmes sentencave ndihmohet shumë të kuptuarit e mësimit. Analiza e proverbave ka karakter plotësues për të kuptuarit e tij. Të mësuarit përmendësh i sentencave ndihmon në të shprehurit e drejtë dhe saktë. P.sh. sentenca **"Serva me, servabo te"** – Më ruaj, do të të ruaj. (Felix I, f. 85), ndihmon nxënësit të përvetësojnë më lehtë kohën e ardhme (futurum). Folja servabo është në kohën e ardhme, mënyra dëftore, zgjedhimi vepror, veta e parë, numri njëjës; folja servo, -are, -avi, -atum 1, ruaj etj.

Me kuptim të ngjashëm, por me ndërtim tjetër është edhe sentenca **"Manus manum lavat"** – Dora lan dorën. (Felix I, f.89). Këtu nxënësi mëson përdorimin e emrave të lakimit të katërt, por edhe kohën e tashme. Manus, -us, f. dorë. Manus është në rasën emërore, numri njëjës, manum në rasën kallëzore, njëjës, ndërsa lavat në kohën e tashme mënyra dëftore, zgjedhimi vepror, veta e tretë, numri njëjës; folja lavo, -are, -lavi (lavavi), lautum (lavatum), 1, laj. **"Donec eris felix (lumtur) multos numerabis amicos"** – Derisa (do) të jesh i lumtur do të kesh shumë shokë (E. Sedaj, "Gjuha Latine", 2006, f. 47). Haset përdorimi i foljes ndihmëse sum, esse, fui, -jam, trajta eris- do të jesh, në kohën e ardhme, mënyra dëftore, veta e dytë, numri njëjës. Numerabis -koha e ardhme, veta e dytë njëjës, folja numero, -are, -avi, -atum, numëroj. Është edhe mbiemri felix -i lumtur, në rasën emërore dhe thirrje njëjës, felix, -icis, adj. i lumtur. **"Duobus certantibus tertius gaudet"** – Kur dy vetë grinden, i treti gëzohet (Felix II, f. 21).

Në sentencë hasen numërorët duobus dhe tertius, numërorë themelorë. Duobus -rasa dhanore (dativus) edhe rrjedhore (ablativus), pra numërori themelor duo -dy, ndërsa tertius është numëror rreshtor, i treti. Poashtu aty është edhe rrjedhorja absolute (rrjedhorja e lirë e shprehur nëpërmjet sentencës), ... certantibus ... , gaudet mënyra dëftore, zgjedhimi vepror, veta e tretë njëjës, folja gaudeo, -ere, gavisus sum, zgjedhimi, II, gëzohem. **"Si duo faciunt idem non est idem"** (Felix II, f. 35). Në këtë thënie përdoret përemri idem. Nxënësit më lehtë mund ta mbajnë mend përmrin dëftor **idem** në rasën emërore, gjinia mashkullore dhe asnjane, si dhe në rasën kallëzore, gjinia asnjane, numri njëjës. Përemri idem (pronomen

demonstrativum) vjen nga isdem, is +dem (genus masculinum), përbëhet nga is, ea, id dhe nga pjesëza e pashtjelluar -dem, ku lakimi është i njëjtë. Numërori duo -dy, është në rasën emërore dhe kallëzore, gjinia mashkullore dhe asnjane. Faciunt -mënyra dëftore, zgjedhimi vepror, veta e tretë, numri shumës, koha e tashme; folja facio, feci, factum, ere, bëj ... , est -koha e tashme, mënyra dëftore, veta e tretë njëjës; folja ndihmëse sum, esse, fui -jam; non -ndajfolje (adverbium), pjesëz mohuese -nuk, s', jo. **"Si vis amari, ama"**! – Duaj, nëse do të të duan!

Nxënësi mëson përdorimin e foljes volo, volui, velle, -dua, dëshiroj ... , vis - koha e tashme, mënyra dëftore, veta e dytë, numri njëjës; si -lidhës (coniunctio, onis f.); amari -paskajorja e tashme në pësore (inf. Pres. Pass.), dhe ama -mënyra urdhërore I (modus imperativus I), veta e dytë njëjës. **"Tantum scimus, quantum memoria tenemus"** – Dimë aq sa mbajmë mend (Felix II, f.47). Tantum -adv. -aq, aq sa, kaq, quantum adv. (pas tantum), aq sa, bash-



Rëndësia e sentencave latine në tekstet shkollore të latinishtes



këlidhor. Scimus, veta e parë shumës, folja scio, scire, scii (scivi), –di ... , memoria –lakimi i parë, rasa emërore, thirrë, rrjedhore e njëjësit si dhe tenemus –mënyra dëftore, zgjedhimi vepror, veta e parë shumës; folja teneo, tenui, –ere, tentum –mbaj etj. **"Quod tibi non vis fieri, alteri non facere"** – Atë që nuk dëshiron të ta bëjnë ty, mos ia bëj tjetrit (Felix II, f. 67).

Nxënësit mësojnë përdorimin e foljes fio, fieri, factus sum –bëhem, dal, ndodh; fieri –paskajorja e së tashmes pësore, quod – lidhëz; tibi –përmë vetor, rasa dhanore njëjës, (pronomen tu); alteri – rasa gjinore njëjës (alter, a, um). **"Docendo discitur (discimus)"** – Duke e mësuar dikë – mësojmë. **"Nihil agendo homines male agere discunt"** – Duke mos punuar asgjë, njerëzit mësohen të bëjnë keq. Docendo, agendo, –gerundium, dativus. Nihil – n. i palakueshëm –asgjë; homines –emërore, kallëzore, thirrëre e shumësit (homo, –inis, m. njeri; male –ndajfolje (adverbium), keq; agere –paskajorja e foljes ago, egi, actum, ere, bëj, veproj ... ; discunt –koha e tashme, mën. dëft., zgjedhimi vepror, veta e tretë, shumës, (dico, dixi, dictum, ere). **"Consilio melius vincas quam ira"** – Me mençuri (këshillë), më shumë do të fitosh, se sa me hidhërim (Felix II, f. 17). Consilio, rasa dhanore dhe rrjedhore, numri njëjës (consilium, ii, n.; melius –ndajfolje në shkallën krahasore; quam –ndajf. –se sa (me krahasore –komparativ); ira –lakimi i parë, rasa emërore, thirrëre, rrjedhore, njëjës; ira, irae f. –zemërim. **"Oppido parvo murus non altus est"** – Për qytetin e vogël nuk duhet mur i lartë (E. Sedaj, "Gjuhë Latine", 2006, f. 35). Në këtë thënie hasen emra të lakimit të dytë, si oppido, (oppidum, –i, n. qytet, murus, –i, m. mur; oppido –rasa dhanore dhe rrjedhore, numri njëjës; murus –rasa emërore, numri njëjës. Në këtë thënie hasen edhe mbiemrat parvo, altus; parvo –rasa dhanore, rrjedhore, numri njëjës (parvus, –a, –um, mbiemër –i vogël; altus –mbiemër, rasa emërore.

Nxënësit, përveç emrave të gjinive të ndryshme të lakimit të dytë, në këtë sentencë do të mësojnë edhe për mbiemrat, ku ndihmohet përvetësimi i tyre.

Gjuha latine - sfidë e këndshme apo ballafaqim i vështirë!? Prof. Enver Sulaj



Titulli i këtij shkrimi përmbledh një mëdyshje në formë pyetjeje, që dëgjohet ndonjëherë nga prindërit e nxënësve që vijnë në Loyola-Gymnasium. Ata druajnë nëse fëmijët e tyre do të mund ta përballojnë një lëndë të tillë. Situatën e komplikon paksa edhe krijimi i një të ashtuquajturit mit mbi vështirësitë e pakapërcyeshme në të mësuarit e latinishtes.

Përvoja dhjetëvjeçare e mësimdhënies në Loyola-Gymnasium ka dëshmuar se procesi i mëimit të latinishtes është ashtu si i gjuhëve tjera (por edhe si i lëndëve tjera mësimore), natyrisht me veçantitë e saj. Por, duhet punë e vazhdueshme për të arritur njohjen e saj, ashtu siç është e domosdoshme edhe njohja e sistemit gramatikor të gjuhës amtare, për të përballuar konceptet gjuhësore latine. Një qasje metodike bashkëkohore e mësimdhënies, mbështetur në tekste shkollore përkatëse, është

një bazë e mirë për një sukses dhe nxënie sa më të lehtë të kësaj gjuhe.

Të mësuarit e latinishtes nuk është thjesht të mësuarit edhe të një gjuhe më shumë (krahas gjermanishtes e anglishtes); është më shumë se kaq – është të mësuarit e historisë e kulturës romake që qëndron në rrënjët e qytetërimit perëndimor; është sistemi i të menduarit që krijoi vlera të përbotshme, e që arriti në sfera të zhvillimit e të përparimit të paimagjinueshme më parë.

Duke mësuar latinisht, nxënësit nxiten vetvetiu të bëjnë edhe analizë krahasimtare me shqipen, si në morfologji e sintaksë, ashtu edhe etimologji të fjalëve, por pse jo, edhe nxitjen e kureshtjes për të njohur historinë, traditën e kulturën e të parëve tanë – ilirëve dhe raportet e tyre me perandorinë më të fuqishme të kohës. Përvoja e të tjerëve tregon se ata që e kanë mësuar mirë latinishten, nuk kanë pasur fare vështirësi që të mësojnë gjuhët tjera. Duke



Gjuha latine - sfidë e këndshme apo ballafaqim i vështirë!?

mësuar latinishten, nxënësit poashtu shohin pikëtakimet e shqipes me këtë gjuhë të vjetër, duke rritur te ta ndjenjën e përgjegjësisë për ruajtjen e gjuhës amtare dhe pastrimin e saj nga fjalët e huaja. Edhe ky aspekt është mjaft i rëndësishëm në këtë kohë të globalizimit, kur kulturat e vogla çdo ditë marginalizohen e rrezikojnë edhe qenësinë e tyre.


Fjalitë e shkurtëra e mendimi i ngjeshur, janë poashtu tipare të latinishtes që ndikojnë gjithsesi në krijimin e një stili personal, përsosmërinë e shprehjes dhe figuracionin në të shkruar.

Të mësuarit e latinishtes është edhe një detyrim moral për të kaluarën tonë, është një përgjegjësi për të ardhmen. E shtruar në formë hipoteze, mund të thuhet se po të mos e njihje Gjon Nikollë Kazazi latinishten, nuk do të hynte në Arkivin e Vatikanit e të gjente aty "Mesharin", librin e parë (të njohur deri më tani) në shqip. Po të mos dinte latinisht Marin Barleti, ne s'do të kishim sot librin e parë për heroin tonë nacional-Gjergj Kastriotin- Skënderbeun, njohja e të cilit nuk do të arrinte aty ku është sot. Përmes latinishtes ne hyjmë në botën krijuese të dijetarëve humanistë shqiptarë, si Barleti, Beçikemi, Maruli, Gazuli etj., por edhe të tjerëve më vonë që ndoqën modele shkrimore në këtë gjuhë.

Duke mësuar latinishten, nxënësit kanë mundësi të shohin ndikimin e saj të thellë në gjuhët tjera, gjermanisht e anglisht (që i mësojnë në shkollë), e poashtu, edhe në gjuhën shqipe.

Sipas gjuhëtarit të njohur shqiptar Eqrem Çabej, latinishtja është gjuha që ka lënë më të thellat gjurmë në shqipen. "Ndikimi i saj shtrihet kryesisht në leksik, po nuk mungon dhe në formim të fjalëve. Në leksik ai ndihet sidomos në këto sfera të jetës: pjesët e trupit, shtëpi, kafshë shtëpiake, vegla, armë e luftë, emra afërie (gjirje), emërtime të kohës, jeta kishtarë, jeta shoqërore e tregtia, bujqësi e pemë, blegtoria, punimi i verës e i vajit, besimet popullore." (E. Çabej, Studime gjuhësore III, fq. 54-55, Prishtinë, 1976)

Sipas shënimeve statistikore, në Loyola-Gymnasium deri në vitin shkollor 2013-2014 maturën e kanë kryer 500 nxënës, ndërsa aktualisht janë 568 nxënës që çdo ditë e mësojnë këtë lëndë, që nga klasa e gjashtë deri në të dymbëdhjetën. Këta të rinj e të reja që kanë dalë nga bankat e Loyola-Gymnasium janë një kontigjent i fuqishëm intelektual që do të reflektojë në të ardhmen e këtij vendi. Kur kësaj i shtohet edhe numri i nxënësve që e mësojnë çdo ditë këtë gjuhë, mund të thuhet lirisht se ky është një thesar i vërtetë me të cilin do të duhej të mburreshim të gjithë.



Por, përveç mësimi në Loyola-Gymnasium, latinishtja do të duhej të ishte pjesë e programeve studimore në fakultete të ndryshme, sepse nuk mund të imagjinohet krijimi i kuadrove në fusha të caktuara pa njohjen e latinishtes. Vetë studiuesit e ndiejnë këtë mangësi në formimin e tyre intelektual, por është përgjegjësi që në të ardhmen këto mangësi të shmangen te të rinjtë që do të fitojnë diploma universitare. Poashtu edhe ndonjë formë e stimulimit për të studiuar shkencat shoqërore mendojmë se do të ishte me interes për fusha të ndryshme të dijes, si gjuhësi, histori, arkeologji etj. Kështu, njohuritë e fituara në shkolllimin paraprak të nxënësve tanë, nuk do të veniteshin në mënyrë graduale, por do të thelloheshin më tej.

Nxënësit e Loyola-Gymnasium, me rezultatet e larta në të gjitha lëndët, të dëshmuara në provimet e maturës, e me njohjen e tri gjuhëve, gjermanisht, anglisht e latinisht, i kanë hapur rrugë të sigurta vetes për të ardhmen. Është njëra nga përparësitë që ata kanë, e për të cilën ata meritojnë të vlerësohen në këtë vend, qoftë në provimet pranuese nëpër universitete, ose


edhe në lehtësira tjera që duhet t'u ofrohen. Sepse është koha e fundit që të vlerësohet dija, e jo vetëm diplomat që po na zënë frymën gjithandej; të stimulojmë një brez të rinjsh që dëshmojnë çdo ditë që këtë vend e duan shumë e këtë dashuri e shprehin në dijet e thella që kanë.

Në fund të shtatorit, gjatë një vizite me nxënësit e Loyola-Gymnasium në vendbanimin e lashtë arkeologjik në Ulpianë, afër Prishtinës, një student historie që e takuam aty u interesua të verifikonte faktin nëse nxënësit tanë mësojnë latinisht. Kur e mësoi këtë fakt, me një ndjenjë mahnitjeje dhe habie njëkohësisht, tha: -Unë në fakultet nuk mësoj latinisht, kurse nxënësit tuaj mësojnë që në klasë të gjashtë.

Nuk kanë thënë kot latinët e vjetër: "Sine lingua Latina nulla intelligentia".

Schule

Latinishtja në Loyola-Gymnasium Agon Belallari – VI c




Para se të vija në këtë shkollë, e dija se do t'i kisha edhe dy lëndë të tjera, latinishten dhe gjermanishten. Në fillim latinishtja m'u duk si një lëndë që s'të hyn shumë në punë. Por, më vonë, e kuptova se çfarë vlere ka gjuha latine. Unë isha shumë kurioz të mësoja një lëndë të cilën e zotërojnë shumë pak njerëz.

Një numër i madh i fjalëve të gjuhës latine janë edhe në gjuhën shqipe, angleze, italiane e kështu me radhë. Prandaj nëse dikush e di gjuhën latine, mund të mësojë edhe shumë gjuhë të tjera. Latinishtja është bazë e shumë gjuhëve, e sidomos e atyre neolatine (gjuha spanjolle, gjuha frënge, italishtja). Kur i mësova fjalët e para në gjuhën latine, pashë se shumë fjalë ngjajnë me disa gjuhë, p.sh. templum- tempull (shqip), temple (anglisht), tempio (italisht). I mësova edhe emrat, mbiemrat, foljet dhe m'u dukën shumë interesante. Mësova edhe se si jetonin romakët e vjetër,

çka ndodhi me vullkanin Vezuf, perënditë romake, sakrificat etj. Kënaqemi shumë duke i mësuar këto gjëra me vlerë.

Latinishtja është edhe gjuhë zyrtare në Vatikan. Kur aty zgjedhet Papa, njerëzit thonë: "Habe-mus Papam!". Kjo do të thotë: "Kemi Papën!". Gjithashtu mali më i lartë i sistemit diellor, që gjendet në Mars, ka emërtim në gjuhën latine dhe quhet "Olympus Mons", që do të thotë "Mali Olimp".

Gjuha latine ka një vlerë shumë të madhe, sepse nga kjo gjuhë janë krijuar shumë gjuhë të tjera. Pra, gjuha latine nuk ka vdekur, ajo ekziston, sepse një numër shumë i madh i fjalëve në gjuhën latine është edhe në gjuhët e tjera.



Shkolla

Përshtypje nga mësimi i gjuhës latine Gjenisa Mandal – VI c



Gjuha latine është një nga gjuhët më të vjetra të botës. Kisha dëgjuar shumë rreth saj, përpara se të vija në këtë shkollë. E mendoja si të vështirë mësimin e saj. Si e vogël me pëlqenin shumë gjuhët e huaja, andaj isha shumë e emocionuar. Pasi u njohëm me profesorin, i cili do të na shoqëronte deri në fund të vitit, i morëm librat. E dija se do të më pëlqente kjo lëndë, sapo e pashë kopertinën e librit. Ajo që më pëlqen te kjo lëndë është se përmes saj mësojmë edhe të kaluarën e popullit romak.

Në fillim mësuam për infrastrukturën romake, vazhduam me mënyrën e jetesës, ushqimit dhe arritëm deri te rënia e Pompejit dhe themelimi i Romës. Nga gjuha latine janë bazuar shumë gjuhë të tjera të botës, si gjuha angleze, gjermane, franceze madje edhe ajo shqipe, të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në aspektin kuptimor, gramatikor, ndërtimor etj, gjë që të ndihmon t'i mbash me mirë në mend fjalët.

Gjuha latine është gjuhë e shume fushave shkencore, si: mjekësisë, biologjisë etj. Gjuha latine, poashtu është gjuhë e teksteve liturgjike. Pas lindjes dhe lulëzimit të gjuhës latine, ajo rreth shek. XVI filloi ngadalë të humbiste funksionin e saj aktiv. Pos këtyre, gjuha latine më pëlqen edhe për fjalët e urta, që shprehin përvojën jetësore të njeriut.



Eksursionet në shkollën tonë - mësim dhe rekreacion

Prof. Maksut Pirku

Në Loyola-Gymnasium, pos mësimit të rregullt dhe shumë aktiviteteve të ndryshme edukativo-mësimore, në planprogram janë paraparë edhe shëtitje dhe ekskursione me qëllim edukativo-arsimor dhe rekreativ.

Shëtitjet dhe ekskursionet i kanë fillet qysh nga shekulli XVIII. Në Britani të Madhe quheshin udhëtimet e të rinjve të klasës aristokrate që i bënin nëpër Evropë, të udhëhequr nga edukatorët e tyre, për të njohur vende europiane. Udhëtimet e tilla shoqëroheshin edhe me argëtim dhe zbavitje. Natyrisht, çdo udhëtim në botën e jashtme, për të rinjtë e klasës aristokrate ka pasur për qëllim arsimin dhe ngritjen e tyre kulturore, në mënyrë që ata të përgatiten për profesione të ndryshme. Aktualisht udhëtimet turistike në botë quhen *tournee* apo *voyage*, anglezët përdorin termin *tourism*, ndërsa gjermanët *Fremdenverkehr* dhe *Tourismus*.

Nëse kemi parasysh ngritjen e cilësisë dhe të edukimit të fëmijëve, çdoherë kemi parasysh aplikimin e metodave të reja të të mësuarit, në atë që nxënësi lexon si dhe aplikon me anë të të pamurit dhe praktikës, që është një ndër metodat më të mira në metodologjinë e të mësuarit efektiv. Gjatë këtij viti kemi planifikuar vizita të shumë objekteve industriale në Kosovë.

Një ndër vizitat është Liqeni i Radoniqit, me klasat e X-ta, ku aty për së afërmi kemi parë



praktikën e shfrytëzimit të ujit si resurs në rajonin e Dukagjinit, përpunimin kimik dhe përgatitjen e ujit të pijes për shfrytëzim etj.

Pos kësaj, me klasat e XII-ta kemi vizituar pellgun e thëngjillit në Obiliq, ku kemi parë pasuritë e thëngjillit që ka bazeni i Kosovës, shfrytëzimin e tyre si resurs, përpunimin kimik- industrial dhe ndotjen e ambientit. Gjatë këtij viti me klasat e XI-ta, një mikpritje të përzemërt kemi pasur në komunën e Hanit të Elezit, ku kemi vizituar fabrikën e vetme të çimentos në Kosovë. Me klasat e IX-ta kemi vizituar Rahovecin, bodrumin e verës "Stone Castle", ku nxënësit kanë parë proceset kimike, përfitim dhe përpunimin e verës.

Pos vizitave me qëllim të mësuarit vizuel e në mënyrë praktike, kemi vizituar edhe shumë monumente historike dhe kulturore në Shqipëri, si kalanë e Krujës, qytetin e Vlorës dhe Monumentin e Pavarësisë së Shqipërisë, Durrësin etj. Po me klasat e IX-ta, gjatë muajit qershor kemi vizituar bukuritë natyrore të Dukagjinit, grykën e Rugovës dhe burimin e Drinit të Bardhë në Radavc.

Gjatë këtyre shëtitjeve nxënësit kanë kombinuar të mësuarit në klasë dhe në praktikë, duke zgjeruar njohuritë e tyre në shumë lëmi shkencore, si kimi, gjeografi, biologji, histori, ekologji, ekonomi e duke ndërlidhur informacionet mes tyre. Ne do të vazhdojmë këtë traditë të ekskursioneve, që nxënësit të kenë më afër qasje në informimin dhe të nxënësit me anën e të gjitha formave, që ndihmojnë ata drejt avancimit të njohurive, duke i përforcuar ato edhe me forma praktike.



Vizita në Radoniq Donjeta Meta - XI a



Të mësosh mbi gjërat që ne i përdorim gati çdo ditë, gjithmonë zgjon kureshtjen tone, mirëpo vërtetimi praktik i këtyre teorive na ofron njohje më të gjerë dhe na ofron mundësinë që çdo pyetje të gjejë përgjigje. Mësimdhënësit tanë gjithmonë bëjnë përpjekje që të na ofrojnë këtë mundësi, e sidomos kur bëhet fjalë për lëndët shkencore, siç është lënda e kimisë.

Gjatë kohës kur ne po mësonim për ujin, profesoresha kishte organizuar një vizitë në Radoniq, në mënyrë që të shihnim nga afër procesin e përgatitjes së ujit.

Kur u nisëm, secili përpiqej të mbante në mend pyetjet në lidhje me këtë temë, në mënyrë që ta shfrytëzonim sa më mire këtë mundësi që na ishte ofruar. Kështu arritëm pranë një ndërtese me shumë dhoma e laboratore, ku ne do të kishim mundësinë të fitonim njohuri edhe mbi detajet më të vogla të përgatitjes së ujit.

Filluam nga dhoma e kontrollit, për të përfunduar në vendin ku ujit i jepej vula për shpërndarje. Gjatë kësaj kohe patëm rastin të shihnim Liqenin e Radoniqit, si dhe pajisjet të cilave vetëm ua kishim përmendur emrat gjatë procesit mësimor.

Kështu përfundoi vizita jonë në Radoniq, duke na lënë të gjithëve të kënaqur, sepse patëm mundësinë që mësimin teorik ta shohim në praktikë. Mundësitë e tilla janë gjithmonë të mirëpritura nga nxënësit, e sidomos kur bëhet fjalë për komponentet më të rëndësishme të jetës, siç ishte në këtë rast uji.

Parlamenti i nxënësve të Loyola-Gymnasium 2013/14 Veton Guraziu - XI b

Të fillosh një punë që nga fillimi është shumë vështirë, por në qoftë se e bën atë me vullnet mund të arrish shumë. Këtë vit pas iniciativës së prof. Neki Jahaj u mbledh parlamenti, që përbëhëj nga përfaqësues të të gjitha klasave dhe filluam së pari ndarjen e detyrave, gjegjësisht mbajtjen e zgjedhjeve për kryesi dhe për profesorët e besueshëm të parlamentit.

Po në këtë mbledhje formuam gjashtë grupe punuese dhe njëkohësisht zgjodhëm kryetarët e grupeve punuese përkatëse. Pas disa mbledhjeve, ku më së shumti diskutohej puna organizative dhe mbledhja e anëtarëve nëpër grupe, ne filluam diskutimin lidhur me idetë të cilat mund të realizoheshin nga ne, nxënësit. Shumë grupe kishin në planprojekte afatshkurtëra dhe afatgjata, por që disa prej tyre nuk u realizuan për shkaqe të ndryshme.


Njëri ndër shkaqet kryesore ishte mospërvoja, në të cilën besoj se s'do të hasim në vitet në vazhdim, por pavarësisht asaj shumë projekte u realizuan me sukses. Nganjëherë ndodhte që nuk e kishim përkrahjen e duhur nga disa profesorë dhe nxënës. Mendimi im se pse nuk e kishim këtë përkrahje është që nuk dihej mirë funksioni i parlamentit të nxënësve.

Kështu ne në fund të vitit shkollor organizuam një mbledhje të parlamentit, ku ishin të ftuar të gjithë profesorët, duke përfshirë edhe drejtorin e shkollës dhe të konviktit. Ne, në atë mbledhje, i paraqitëm të gjitha projektet e realizuara dhe jo të realizuara gjatë vitit shkollor 2013/14, dhe gjithashtu treguam që parlamenti ka për qëllim që t'i integrojë nxënësit në aktivitete jashtëmshimore, që janë në të mirën tonë dhe të shkollës, t'ua mësojë punën në grup, punën si shoqëri civile, mundësinë për të dhënë ide dhe diskutimin se si t'i realizojmë ato dhe gjithashtu na jep mundësinë për ndryshimin e disa gjërave në shkollë, që mund të jenë pozitive për të gjithë ne.

Pas paraqitjes së punës të parlamentit, dhuruam dhe shpërblimet për grupin më të mirë dhe projektet më të mira të realizuara gjatë këtij viti. Fare në fund vazhduam edhe me një koktej rast, ku nuk munguan lavdatat e të pranishmëve për punën që kishim bërë ne, nxënësit.



Das Schülerparlament des Loyola-Gymnasiums 2013/14 Veton Guraziu - XI b



Von vorn anzufangen, fällt schwer, aber wenn man den Willen hat, kann man viel erreichen. Deshalb ist das Schülerparlament, bestehend aus den jeweiligen Klassenvertretern, nach einer Initiative von Neki Jahaj, wieder entstanden.

Zunächst wurden die verschiedenen Posten verteilt, sprich die Wahl des Schulsprechers sowie die Wahl der Vertrauenslehrer. In dieser Versammlung wurden auch 6 Arbeitsgruppen gebildet und ihre jeweiligen Vertreter bestimmt. Nach vielen Versammlungen, in denen es hauptsächlich um organisatorische Dinge, wie die Posten der Parlamentsvertreter und die Verteilung der Mitglieder in die Gruppen ging, begannen wir mit der Diskussion über Projekte, welche von uns, den Schülern, realisiert werden können.

Viele Gruppen hatten lange und kurze Projekte vorausgeplant, aber manche von ihnen konnten aus verschiedenen Gründen nicht realisiert werden. Einer der Hauptgründe war die fehlende Erfahrung der Schüler, von der ich aber glaube, dass wir sie in den folgenden Jahren erlangen werden. Abgesehen davon waren viele Projekte erfolgreich. Manchmal fehlte es uns an der Unterstützung einiger Lehrer und auch Schüler. Meiner Meinung nach war dem so aufgrund fehlender Informationen über den Sinn des Schülerparlaments.

Am Ende des Jahres wurde vom Schülerparlament ein Abend organisiert, zu dem alle Lehrer, der Schulleiter und der Leiter des Internates, herzlich eingeladen waren. An jenem Abend wurden alle Projekte des Jahres 2013/14 vorgestellt, auch jene, die nicht realisiert worden waren. Außerdem sprachen wir über unser Ziel, die Schüler in außerschulische Aktivitäten zu integrieren. Schüler sollen lernen in einer Gruppe zu funktionieren, die Arbeit in einer bürgerlichen Gesellschaft, Kreativität und Diskussionsbereitschaft sind weitere wichtige Punkte.



Das Schülerparlament gibt uns die Möglichkeit, die Schule im positiven Sinne zu verändern.


Nach der Vorstellung der vielen Projekte wurden die Besten des Jahres ausgezeichnet und Preise vergeben. Am Ende gab es Cocktails und es fehlte nicht an Lob für die harte Arbeit, die wir, die Schülerschaft, in das Parlament investiert haben.

Ich persönlich denke, dass das Parlament etwas ist, das wir Schüler wirklich benötigen, da wir dort unseren Ideen außerschulisch freien Lauf lassen und unsere Talente ausleben können. Ich hoffe außerdem, dass wir in den folgenden Jahren von allen Seiten unterstützt werden, da wir gemeinsam noch größere Projekte realisieren können.

Mua personalisht më duket se parlamenti është një formë organizimi që me të vërtetë na duhet, sepse aty mund t'i shprehim idetë, talentet që i kemi, përveç mësimit. Shpresoj se në vitet në vazhdim të kemi përkrahje nga të gjithë, sepse së bashku mund të realizojmë projekte edhe më të mëdha.

<i>Kryesia e parlamentit Vorstand des Schülerparlaments</i>	
Kryetar: Vorsitzender:	Veton Guraziu
Nënkryetarët: Stv. Vorsitzender:	Anita Bala, Fjolla Hoxha
Profesorët e besueshëm: Mentoren:	Vlora Grajçevci, Enver Sulaj
Mbajtja e protokolit: Schriftführer:	Donjeta Meta
Bashkëpunëtorë: Mitglieder:	Mimoza Spaqi, Florian Hoxha, Shendi Krasniqi

<i>Grupet punuese: Arbeitsgruppen:</i>		
Grupi i filmit: Filmgruppe:	Grupi i gazetës: Schülerzeitung:	Grupi i sportit: Sportgruppe:
Kryetare: Donjeta Meta Gruppenleiter:	Kryetare: Arta Hoxha Gruppenleiter:	Kryetar: Driart Çerreti Gruppenleiter:
Grupi i riciklimit: Recycling:	Grupi i arteve: Kunstgruppe:	Grupi i tutorëve: Tutoren:
Kryetare: Dijana Latifaj Gruppenleiter:	Kryetar: Dafina Morina Gruppenleiter:	Kryetar: MimozaSpaqi Gruppenleiter:
Mbështetëse: Filomena Laçi Mentor:	Mbështetës: Shpejtim Buqaj Mentor:	Nismëtare: Rina Celina Mentor:
	Grupi i shkencave: Wissenschaftsgruppe:	
	Kryetar: Rron Guguli Gruppenleiter:	



Këtë vit jemi munduar që sadopak përmes organizimit të klubeve të reja, t'i ofrojmë shkollës disa projekte të reja dhe interesante. Pjesë e këtyre klubeve që u formuan ishte edhe klubi i filmit. Interesimi nga nxënësit ishte shumë i madh, kështu u hartua një listë e vogël me emra nxënësish nga klasat e gjashta e deri te klasat e dhjeta. Duke shtuar kështu edhe punën në klub, pasi që secilit mundoheshim që t'i gjenim një detyrë të veçantë. Në organizimin e brendshëm të klubit, pra në ndarjen e anëtarëve kishim tashmë regjisorë, aktorë, skenaristë etj.

Aktorët e rinj, pra nxënësit e klasës VI c, ishin shumë të gëzuar që ishin pjesë e një aktiviteti të tillë, prandaj edhe në mbledhjet të cilat u mbajtën me këta anëtarë, vendosëm që pikërisht projekti i parë të ishte drama e titulluar "Nata e Vitit të Ri", e cila kishte një skenar të padëgjuar më parë. Nxënësit donin që gjithçka të ishte e përkryer, prandaj shpeshherë na ndodhte që të bënim prova të shumta, derisa më në fund e finalizuam projektin, duke e shfaqur kështu dramën tonë para publikut i cili i prit me shumë ngrohtësi, duke u krijuar fëmijëve një ndjenjë krenarie. Mirëpo nuk u morëm vetëm me realizimin e projekteve, ne gjithashtu organizuam një orë debati pas shfaqjes së filmit "Kolonat", i cili trajtonte temën e luftës në Kosovë. Ndonëse temë e ndjeshme, reflektimet e nxënësve mbi këtë temë të linin gojëhapur.

Më pas vazhduam sfidën tonë më të madhe e cila ishte realizimi i një filmi të shkurtër, të realizuar nga ne. Prandaj, kështu filluam së pari me shtjellimin e idesë, vendosjen e skenave, zgjedhjen e personazheve, e në fund pastaj, xhirimet. Kjo ishte një përvojë tërësisht ndryshe, sepse idetë ndryshonin në çast, duke bërë kështu që më në fund të finalizonim edhe këtë projekt të quajtur "Dauntless", i cili u paraqit gjatë pushimit të gjatë, mirëpo edhe në Hamburg gjatë shkëmbimit të nxënësve, ku u prit me mjaft entuziazëm. Por, as kaq nuk na mjaftoi për të përmbyllur aktivitetet në klubin e filmit, sepse vendosëm që për 16 Prill të realizonim një film dokumentar që fliste për shkollën. Kryesisht u mbështetëm në intervista të bëra me nxënës të rinj, duke filluar nga klasa e gjashtë e deri në klasën e dhjetë, me theks të veçantë te maturantët të



Klubi i filmit

cilët tani do të largoheshin. Mirëpo nuk i lamë anash as nxënësit që kishin qenë më herët në "Loyola", të cilët tani flisnin me shumë nostalgji për gjithë përvojën e kaluar. Pamjet u xhiruan në të gjithë shkollën, për t'u përshtatur më pas edhe me titullin e filmit "Shkolla jonë". Filmi u prit shumë mire, jo vetëm nga pjesëmarrësit, por edhe nga vizitorët të cilët nuk i kursyen lëvdatat për punën e bërë.

Me këto projekte të realizuara dhe me disa të tjera që mbetën në letër, e përmbyllëm një vit të suksesshëm me plot aktivitete të reja, duke u vlerësuar më pas edhe si klubi më i mirë nga ana e Parlamentit të shkollës.



Shkolla

Kino-Loyola
Anitë Bala – XII b



Që nga viti i kaluar, në konviktin e Loyola-Gymnasium, është formuar grupi i filmit. Ky grup organizonte gjatë qëndrimit dyjavor të konviktorëve, shfaqjen e një filmi me tematikë të caktuar. Shfaqja e filmave ishte gjithmonë e mirëpritur dhe e dëshiruar nga ana e nxënësve.

Edhe këtë vit, së bashku me edukatoren Filomena Laçi, vendosëm që të vazhdojmë me shfaqjen e filmave, ngase ky ishte një aktivitet i mirëpritur nga nxënësit që sillte freski në jetën konviktore.

Dita e shfaqjes së filmit ishte gjithmonë ditë e premte, e veçanta e këtij viti ishte se ishim pajisur nga shkolla me të gjitha kushtet për shfaqjen e filmave, gjë që na bëri më të këndshme çdo mbrëmje ku ne shfaqnim filmat. Disa nga filmat të cilët i shfaqëm "ears a slave", "The book thief", "Happy wedding", "Frozen" etj.

E pyeta ed. Arianit Çollaku, i cili e mirëpriti idenë time. I njoftova të gjithë nxënësit në konvikt, që sipas gjeneratave të formoheshin ekipet e volejbollit. Ata e pritën shumë mirë këtë gjë dhe grupet e volejbollit u formuan shpejt, ndësa shorti do të hidhej ditën e diel, kur do të mbahej edhe turneu. E pritë me entuziazëm të dielën, por koha ecte shpejt dhe e diela erdhi. Pasi përfunduam hedhjen e shortit, filluam menjëherë lojën. Çdo gjë ishte shumë e bukur, të gjithë po kalonin mirë, ndërsa unë isha shumë i lumtur, sepse m'u dha mundësia që të organizoja diçka të tillë. Pra, më në fund gjeta përgjigje në pyetjet që kisha në mendje. Sa i përket fituesve të turneut, lojërat e para i fituam pa asnjë vështirësi, por loja e fundit (finalja) ishte shumë e vështirë për ta fituar, por ne i mblodhëm forcat dhe arritëm qëllimin që kishim nisur dhe e fituam vendin e parë. Unë jam i lumtur që përveç mësimit, kam hapësirë të tregoj talentin tim në sport.



Konvikt

Shkallët e suksesit Donika Berisha - X d



Të jesh i arsimuar, do të thotë të jesh i sukseshëm. Të udhëtosh drejt atij suksesi është sikur të ngjitesh nëpër shkallë, ndonëse ky rrugëtim është i vështirë, por kur të ngrihesh në majë të atyre shkallëve do ta shohësh botën në një këndvështrim më ndryshe se të tjerët. Udhëtimi i suksesit për mua filloi këtu në Loyola-Gymnasium, në vendin ku të arriturat orientohen drejt meje. Ardhja këtu më dukej shumë larg, aq larg sa edhe vetë yjet për të cilët vetëm imagjinoj e s'më duken realë. E gjithë ajo rrugë më dërgoi para dyerve të Loyola-Gymnasium.

Emocionet e kishin kapluar qenien time. Më frikësonte fakti se si do t'ia bëj këtu, me kë do të rri, a do ta kem përkrahjen e ndonjë personi? Ishte edukatorja dhe shumë vajza, si puna ime, që fil-luan të më përkrahin. Familja ishte e vetmja mungesë këtu. Me kalimin e ditëve filloi të kalonte edhe mërzia.


Gjëja e cila më dha një shtytje të madhe të vazhdoja të isha pjesë e Loyola-Gymnasium, ishte një turne i vogël në futboll, ku e shpreha talentin tim. Aty unë dola triumfuese, duke lënë mbrapa edhe shumë vajza tjera të talentuara. Ky ishte momenti i cili ishte shkaktari më i madh që ndikoi që unë të ndihesha njëloj sikurse në shtëpinë time, kjo ngase të gjithë vraponin drejt meje për të më uruar, dhe njëkohësisht, për të më falënderuar për lojën të cilën unë dhe vajzat e grupit tim ua dhuruam.

Ky është njëri ndër sukseset, i cili më bëri që të ngjitesha edhe një shkallë më lart, për të arritur deri tek kulmi i suksesit, i cili shpresoj që do të ndodhë pikërisht këtu, në Loyola-Gymnasium.



Internat

Në Rugovën e bukur Valentin Frrokaj - XI d




Mundësia më e mirë që të kalosh kohë të bukur me shoqërinë, është të vizitosh bukuritë e Kosovës, dhe ne kështu vizituam Rugovën, ku kaluam një fundjavë shumë të bukur.

Të shtunën, më 27.09.2014, pasi mbaruam mësimin, ne, të gjithë maturantët që jetojmë në konvikt, u nisëm për në Rugovë. Gjatë rrugës kaluam shumë bukur. Disa këndonin, disa dëgjonin muzikë, e ndonjëse rruga zgjati katër orë, për ne ishte diçka shumë e bukur e aspak e mundimshme.

Kur arritëm në Rugovë (te Guri i kuq), së pari u vendosëm nëpër shtëpiza, pastaj filluam që të bëjmë përgatitjet për të ndezur zjarrin. Kështu, ne së bashku me edukatorët, ndezëm zjarrin dhe filluam të përgatisim ushqim në skarë, dëgjonim muzikë dhe u argëtuam shumë. Pastaj u mblodhëm të gjithë rreth zjarrit dhe filluam të këndonim, të tregonim ngjarje të ndryshme. Kjo gjë zgjati deri në orët e vona të pasmesnatës. Ishte një natë shumë e bukur për të gjithë, ndërsa të nesërmen u zgjuam në mëngjes dhe filluam të bënim përgatitje për t'u kthyer. Kishim vendosur që të shkonim për drekë te "Trofta e Drinit", në Radavc, aty ku buron Drini i Bardhë. Në orën 12 u nisëm për te "Trofta e Drinit" dhe kur arritëm të restoranti gjetëm pritje shumë të ngrohtë dhe kështu kaluam një kohë shumë të bukur. Pas drekës, morëm rrugën për t'u kthyer në konvikt.

Gjatë rrugës disa flinin, sepse ishin të lodhur pas asaj nate të gjatë e të bukur, por as shakatë nuk mungonin. Kur arritëm në konvikt të gjithë ishim shumë të gëzuar dhe shumë të kënaqur, sepse kishim kaluar një fundjavë që do të mbetet për një kohë të gjatë në mendjet tona.



Konvikt

Një fillim i ri Anita Gegaj - X d



Si çdo fillim, edhe për mua ishte e vështirë dita e parë në një vend të ri. Ishta shumë e lumtur kur më njoftuan se kisha kaluar provimin pranues në Loyola-Gymnasium. Ndjenjat ishin përzier, nuk e kuptoja, ishtë gëzim, apo hidhërim?!

Çdoherë kur përmendet muaji shtator, në mendje më vjen shkol-la. Më rikthehen në mendje ditët e mësimin, që jorrallë ishin të mundimshme dhe me probleme. Çdo muaj kishte gjëra të reja, që më motivuan për suksese tjera. Këtë vit ishte më ndryshe. Dëshira për të gjetur shoqëri pas pushimit, thajse ishte e paralelizuar. Drejtimi i dëshirave dhe mendimeve ndryshoi dhe mori kahje dhe rrugëtim tjetër. Ndoshta fakti që isha nxënëse e një shkolle tjetër, më bënte të ndihesha më ndryshe.

Thjesht, nuk mund ta paramendoja se po ndërroja ambientin e po lija shoqërinë. Mirëpo emri i shkolles së re më dha forcë. Shumë herë isha në dyshim se si do të gjendesha në këtë shkolle. Si do të shfaqesha unë e si do të silleshin të tjerët me mua? Pas të gjitha këtyre dyshimeve, mendimeve dhe dëshirave, erdhi dita që po e prisja, së bashku me të gjitha iluzionet që kisha në kokë. Erdhi 1 shtatori në Loyla-Gymnasium, që për mua ishte sikur shtatori i parë kur kisha shkuar në shkolllën fillore. Gjithçka ishte më ndryshe, ngase e paramendoja. Çdo gjë ishte një strukturë e ngërthyer në vetë. Me kohë u ambientova. Gjithë ato fytira të panjohura më shkaktonin habi, kishte edhe shumë të tjerë si unë, që ishin të habitur dhe të vetmuar, njëkohësisht.

Njohja me të tjerët ishte e rëndësishme në atë kohë të çrregulluar. Njohja me profesorët më bëri të kuptoja konceptet e shkolles, ndërsa nxënësit më bënë të kuptoja jetën në një komunitet tjetër. Prandaj kjo ditë ka zënë një vend në zemrën time. Këtë fillim të ri do ta kujtoj gjatë dhe me nostalgji. Pra, nuk është gjithmonë i saktë paragjykimimi ynë, pa e njohur i vertetur në realitet.



Internat

"Loyola" - përvojë për t'u mbajtur mend Rozafa Latifaj & Ilirjan Lleshi – XII c


Jeta është shumë e çuditshme. Në momentet kur ti mendon se përfundoi gjithçka, ajo të hap një derë të re, një fillim të ri. Kështu ishte ardhja jonë në Loyola-Gymnasium. Në momentet më stresuese, prindërit tanë na dhuruan një shpërblim të tillë. Sigurisht që emocionet dhe dëshira për të parë këtë shkollë ishin të pafundme. Erdhi dhe dita kur ne shkelëm për herë të parë në këtë shkollë. E gjitha dukej si një ëndërr. Nata erdhi shumë shpejt, prindërit duhej të shkonin dhe këtu filloi sfida e parë për ne. "Mbijetesa", siç e quanim ne ëndrrën e shndërruar në një vend të panjohur. Të tilla mendime na solli jeta në konvikt.

Ditët kalonin pa u kuptuar. Koha nuk ndalonte asnjë sekond, lindën ndjenja të reja, dije të reja, ne krijuam një familje të re, por ende nuk arritëm ta pranonim. Thoshim gjithmonë: "Unë kam vetëm një familje dhe një do ta kem gjithmonë." Epo, ja që nuk doli ashtu. Por kjo ndodh kur ti njeh vetëm një anë të botës.

Tre vjet kaluan shumë shpejt. Erdhi dhe dita kur ne do të quheshim maturantë. Erdhi dita kur ne do t'i jepnim njëri-tjetrit përqafimet, ndoshta të fundit. Në këto momente gjithçka duket shumë më ndryshe. Sa e çuditshme, sa shumë të mësojnë vitet. Ne arritëm të krijojmë një shoqëri të cilën e bashkon dashuria. U bëmë me prindër të shumtë, pasi që ata të duan ashtu si je dhe të japin përkrahje, e meritojnë të quhen prindër. Tani gjithçka është e qartë. Një familje tjetër krijuam, por kësaj radhe ajo ka rreth vetes besim, guxim, shpresë dhe pjekuri të mjaftueshme për të ndërtuar vetë fatin tonë.

Tani ne jemi gati të nisim një fillim të ri. Jemi gati t'i dalim përpara realitetit dhe t'u dalim zot synimeve tona. Ne jemi të sigurtë për atë që jemi, e kjo falë vetëm kësaj shkolle të cilës i takojnë meritat e para. Për ta mbyllur këtë fund, ne duam të themi:

"Faleminderit për gjithçka dhe mirupafshim familje e dashur, por kurrë lamtumirë!"



Konvikt

Jeta në konvikt Furtuna Kulludra - XI d



Konvikti për mua është si shtëpi e dytë, pasi që më shumë kohë kaloj këtu, sesa ne shtëpi. Tani më jam adaptuar me konviktin edhe rregullat, sepse jam në vitin e dytë në Loyola-Gymnasium dhe çdo gjë më

duket më e lehtë. Gjithçka është në vendin e duhur dhe shkon në bazë të rregullave të shkollës.

Këtu jetën e kemi të programuar dhe kemi një orar të saktë kur kemi për të mësuar, kur mund të dalim, kur duhet të hamë e kështu me radhë. Edukatorët na ndihojmë kur kemi nevojë, por kemi edhe shokët dhe shoqet të cilat na mbështesin në këtë aspekt. Koha që e presim më së shumti ne konviktoret mund të them se është koha kur vjen fundjava dhe duhet të shkojmë në shtëpi. Të gjithë presim me padurim orën e fundit të së premtes, që të marrim valixhet dhe të nisemi drejt shtëpisë.

Për një moment në hapësirat e shkollës dhe të konviktit bie qetësia dhe ne vrapojmë te prindërit, duke i përqafuar pas një kohe të gjatë. Disa mund të thonë që jeta në konvikt është e mërzitshme, por ka edhe momente të paharrueshme këtu, të cilat do t'i kujtojmë me nostalgji pasi ta përfundojmë shkollimin.

Ditët e para në konvikt Vaid Kryeziu - X d



Pranimi im në këtë shkollë ishte diçka e mrekullueshme. Nuk më besohej që një ditë do ulesha në bankat e Association "Loyola-Gymnasium".

Provimi pranues ishte ndër sfidat më të

mëdha në jetën time. Është vështirë larg familjes, por ia vlen, sepse kjo largësi do të na ndihmojë në të ardhmen.


Tash, pasi jam këtu, e shoh rëndësinë e kësaj shkolle. Në fillim mendoja se do të ishte më e vështirë, por tash e kuptova të vërtetën se këtu ditët shkojnë sikur minutat, e javët sikur ditët. Të studiosh përkrah këtyre edukatorëve, profesorëve, shokëve e shoqeve, e ardhmja ime pa dyshim se do të jetë e sigurt dhe jam shumë i bindur për këtë fakt.

Sa herë e mendoj ditën e parë këtu, emocionohem si të isha në fillim. Për këtë shkollë çdo fjalë është e tepërt.

Në këtë shkollë jam i bindur se do të kaloj çastet më të bukura të jetës sime. Dhe për fund: Jam krenar që jam pjesë e kësaj shkolle.

Internat

Rugova Genta Gashi - XII b



Udhëtimi për në Rugovë ishte diçka e mrekullueshme, që e përjetuam gjatë shkollimit këtu, e që është bërë pothuajse traditë. Rruga u shoqërua me një entuziazëm të madh, sidomos për shumicën e nxënësve që udhëtonin për herë të parë drejt maleve të Rugovës. Pasi mbërritëm atje, formuam grupe nxënësish që mblidhnin drurë, përgatitnin skarën e deri tek ata që përkujdeseshin për muzikën. Pas darkës ndezëm një zjarr të madh, përreth të cilit u mbodhëm të gjithë, duke përfshirë edhe edukatorët tanë, drejtorin Arianit Çollaku dhe edukatoren, Filomena Laçi.

Aty diskutuam lidhur me tema të ndryshme, por nuk munguan as këngët me kitarë. Së bashku qëndruam deri në orët e vona të natës. Pas këtyre përjetimeve, erdhi koha e gjumit.

Në mëngjes, pas lindjes së diellit, ne u frymëzuam nga natyra e bukur e Rugovës. Në mesditë, fatkeqësisht erdhi koha për t'u larguar. Kishim kënaqësinë që gjatë kthimit të ndaleshim në ambientin e bukur të Radacit të Pejës e të hanim drekë së bashku. Gjatë këtij udhëtimi kemi vërejtur se koha e lumtur kalon shumë shpejt, ndjesi për të cilën më kishin rrëfyer edhe shoqet e gjeneratave të kaluara. Pjesa më e bukur e kësaj historie ishte fakti që edhe unë, më në fund e përjetova këtë udhëtim me gjeneratën time. Këto ishin dy ditët më të mrekullueshme, për të cilat e ka vlejtur të pres shtatë vjet. Por edhe Rugovës i erdh fundi, ndërsa pas mbërritjes në konvikt, iu kthyem përditshmërisë sonë.

Vitet do të kalojnë shpejt, por kujtimet do të jenë pjesa më e bukur.

Konvikt

Një jetë ndryshe Kron Gashi - X e



Jeta në konvikt është më ndryshe nga jeta që kemi pasur deri tani, sepse ne, si brez i ri, jemi mësuar të jetojmë pa asnjë lloj mundimi. Këtu është ndryshe, këtu duhet të jesh i zoti i vetvetes, ose nuk do të kesh sukses

sikur të tjerët. Kjo është arsyeja që unë e pëlqej këtë vend. Ardhja ime deri këtu, po ashtu ishte interesante.

Pesë ditë para provimit pranues, kuptova se kjo shkollë ekzistonte dhe se ishte një zgjidhje e mirë për të ndryshuar drejtimin e jetës sime. Në fillim më dukej vështirë, deri sa arrita të mësohesha me kushtet që të ofron kjo shkollë. Të jesh larg familjes një kohe të gjatë, nuk ishte e lehtë, por ja që tani jam këtu dhe mendoj se jam një ndër njerëzit më të lumtur në botë.

Tani më nuk është vështirë për mua, sepse ne nxënësit jemi bërë si familje dhe ndoshta kjo më ndihmon që mos të ndihem i vetmuar. Jam shumë i kënaqur me hapësirën ku jetoj, është thjeshtë e mrekullueshme.

Organizimet në Loyola-Gymnasium Marigona Kryeziu - XI d



Organizimet në ALG Loyola-Gymnasium s'kanë të ndalur. Vizituam gati çdo vend, festuam çdo festë, por festa më e madhe në këtë shkollë është Dita e Dyerve të hapura. Si çdo vit, edhe kësaj radhe u bënë përgatitje të shumta që çdo

gjë të ishte në rregull. Të gjithë nxënësit ishin të angazhuar në detyrat e tyre. Ishte viti im i parë këtu, por as unë nuk dalloja nga nxënësit e tjerë, sepse edhe une isha e angazhuar në këto aktivitete. Emocionet shtoheshin dita-ditë dhe mezi e prisja 16 prillin, Ditën e dyerve të hapura. Për fat të keq, këtë vit moti nuk ishte i mirë, binte borë dhe festa u mbajt brenda në sallën e sportit. Ajo sallë ishte e stërmbyshur me njerëz. Programi i shkollës ishte i mrekullueshem, kishte mysafirë edhe nga vende tjera të cilët u ndanë shumë të kënaqur me programin që u shfaq atë ditë. Çdo gjë shkoj në rregull, ashtu siç e kishim menduar. Ditët kaluan dhe erdhi fundi. Shkuam në shtëpi, por mezi prisnim të ktheheshim prapë në shkollë.

E dinim, se pasi të ktheheshim në shkollë, na prisnin shumë organizime e aktivitete të ndryshme dhe kështu doli. Në javën e dytë në shkollë, drejtori i konviktit kishte organizuar që ne klasat e XI-ta të shkonim për një udhëtim me tren për në Pejë, Deçan dhe Junik. Për mua ishte një emocion i veçantë të udhëtoja me tren, ngase ishte hera e parë. U kënaqëm shumë atë ditë dhe nuk besoj se ishte hera e fundit që na befasuan me atë udhëtim. Përderisa jam në këtë shkollë, pres edhe befasi tjera të këndshme.

Internat


Shetitje me tren Edina Bajrami - XI e

Mundësia për një përvojë të mjaftueshme për jetë si dhe argëtimi, lojërat apo kuizet e ndryshme, nuk mendoj se gjenden diku tjetër. Një ambient i këndshëm për zhvillimin e një gjenerate të shëndoshë. Sa u përket shetitjeve mendoj se janë mjaft të dobishme, po aq edhe argëtuese si p.sh. ajo e fundit në Pejë, Junik dhe Deçan.

Të vizitosh qytetet e vendit tënd si dhe të njohësh kulturën e tyre, është gjë shumë e bukur dhe relaksuese. Të shohësh se sa vlerë u jepet gjërave nga historia e lashtë më la mbresa, sepse kështu mund të kuptoj se pasi të kalojnë disa shekuj përsëri çdo gjë që ne do të lëmë pas do të ruhet.

Diçka e veçantë që më la përshtypje të mëdha ishte ngrohtësia, butësia si dhe dashamirësia e njerëzve, gjë e cila ishte e njëjtë në çdo qytet apo fshat që ne vizituam dhe kjo më bëri të kuptoj se njerëzit e tillë janë mjaft të vlefshëm.

Po ashtu duhet theksuar edhe udhëtimin me tren i cili nuk është transport i cili përdoret aq shumë në Kosovë. Ishte mjaft mbresëlënëse sidomos pamja madhështore e relievit që ishte tej mase qetësuese. Gjithçka që kalova brenda një dite ishte e papërshkrueshme dhe një shetitje që nuk do ta harroj për një kohë të gjatë.



Konvikt

Loyola-Gymnasium - ëndrra që u bë realitet Donjeta Cenaj - X d



Si çdo fëmijë që ka ëndrrat e tij, edhe unë kisha një të tillë. Një i afërm imi kishte treguar për një shkollë për të cilën s'kisha dëgjuar më parë, dhe më kishte thënë që quhej "Loyola". Ai e bënte aq madhështore, sa që unë nuk mund t'u besoja dot veshëve të mi. Unë atëherë isha në klasën e IX-të.

Interesohesha se ku do vazhdoja shkollimin e mesëm të lartë. Në fillim kisha mjaft dilema, por më pas i hoqa këto dilema. Kisha arritur të marr informacione të shumta për "Loyolën". Çdo ditë e më shumë mësoja diçka të re në lidhje me shkollën dhe dashuria për të rritej.


Gjithmonë ëndërroja të isha pjesë e një stafi të madh me frymë gjermane, ku mbizotëron arsimimi i mirëfilltë. Së bashku me prindërit vendosëm që unë të regjistrohem në këtë shkollë.

Kisha kaluar pothuajse të gjitha muret që më ndanin nga realizimi i ëndrrës sime. Më kishte mbetur vetëm edhe testi pranues, i cili kaloi me një emocion më të madh se sa e prisja, por unë i kisha mbledhur të gjitha forcat e mundshme.

Ishte ditë e martë, kur mora lajmin se isha pranuar. Në atë moment mbeta e shtangur, nuk dija ç'të bëja, të bërtisja apo të qaja. Ishta mjaft e hutuar, por edhe tejet e gëzuar. Tashmë me padurim e prisja ditën, që të vija në shkollë. Çdo ditë që kalonte e rrumbullakosja në kalendar. Kishte mbetur vetëm edhe një ditë, kurse unë kishte kohë, që isha përgatitur. Erdhi edhe momenti i shumëpritur. Ishta shumë e gëzuar, por njëkohësisht edhe e mërzitur, sepse po ndahesha nga familja ime për të cilën më merr malli shumë, mirëpo kjo është vetëm një sprovë e jetës. Për një çast mbylla sytë, u hap një portë e madhe, porta e ëndrrës sime. Ishte ajo ditë që e prisja. Ëndrra ime u bë realitet. Në ditarin e jetës sime hapa një faqe të re në të cilin shkrova:

"Një ëndërr që u bë realitet - Loyola-Gymnasium."

Shëndeti mbi të gjitha Edona Hoxha - XI d



Të jesh i pasur, ndonjëherë nuk do të thotë të kesh gjithçka. Janë disa gjëra, të cilat jo gjithmonë mund të kenë vlerë aq të madhe, sa të paguhen me para. Ka shumë njerëz në botë të cilët vuajnë nga sëmundje të ndryshme, madje edhe të pashërueshme, në mesin e të cilave bën pjesë edhe kanceri. Kur e dëgjojmë këtë shprehje, të gjithë mendojmë për më të keqen, si një rrugë që ka destinacion vdekjen, mirëpo ajo që ne nuk i kushtojmë rëndësi janë disa gjëra të vogla, por shumë të çmueshme.

Por a mund ta parandalojmë kancerin? Çfarë nëse ai vërehet me kohë?

Pyetje të shpeshta të cilat na fusin në një pus mendimesh, përgjigjet e të cilave asnjëherë nuk mund t'i mësojmë nëse nuk interesohemi për to, sepse, harrojmë një gjë mjaft të rëndësishme:

"Sot jam unë i prekur nga kjo sëmundje, nesër mund të jesh edhe ti." Është e vërtetë se femra konsiderohet si gjinia e bukur dhe për këtë ato kërkojnë një kujdes të veçantë. Gjiri nuk është vetëm pjesë e trupit, e cila merret për bukuri, apo edhe si simbol i femrës; në fakt ka vlerë më të madhe, është organ ushqyes për foshnjën. Ja përse i detyrohem të gjithë ne një kujdes të veçantë.

Kanceri, si një sëmundje e cila kohëve të fundit ka filluar të përhapet shumë, e sidomos tek femrat, i ka bërë njerëzit të tronditen për pasojat fatale që sjell. Dhe nëse nuk mund ta ndalim, atëherë mund ta parandalojmë atë. Kjo është ajo që ne nxënësit e konviktit e mësuam gjatë një dokumentari të shfaqur nga edukatorja Filomena Laçi dhe grupi i saj. Ajo që ne kuptuam ishte se jo gjithmonë kanceri është vdekjeprurës, por mund të shërohet falë disa kontrollimeve të vogla e mjaftë të rëndësishme. Andaj çdo njeri i detyrohet vetvetes se tij të bëjë kontrollime sa më të shpeshta, pasi që teknika ka përparuar mjaft në ditët e sotme dhe nëse nuk do ta bëjë për vete, ta për nënën, motrën e tij. Le të jetë kjo një mësim për të gjithë, pasi që jeta ofron vetëm një mundësi për ta jetuar.

Përshtatja në një rreth të ri Yll Krasniqi - XI e




Është e natyrlshme të për-mallohesh për vendin tënd, gjatë dy javëve të para të cilat nevojiten për t'u përshtatur me jetë e re. Nga njëra anë, për një periudhë të caktuar nuk ka më lëvizje të lirë, nuk ka pyetje

se ku jeni apo me kë jeni, ka vetëm lajmërimi të vazhdueshme për të bërë detyrat e shtëpisë, për të mësuar etj.

Në anën tjetër, duhet të dish që je vetvetja e kjo ndodh, ndoshta për herë të parë në jetën tënde. Ne në shtëpi jemi mësuar që dikush tjetër të merret me ne, posaqërisht prindërit, si për detyrat e shtëpisë, kohën e lirë, kurse këtu është e kundërta; këtu kujdesen për ne edukatorët, që bëjnë më të mirën e tyre duke zëvendësuar prindërit tanë.

Nga ky këndvështrim mund të them se konvikt i Loyola- Gymnaisum është një mësim shumë i rëndësishëm në jetën tonë. Ky konvikt është një vend ku ka gjithçka që të nevojitet për të mësuar dhe për të kaluar kohën e lirë. Studiuesit thonë se mënyra më e mirë për të thyer monotoninë e konviktit është që të përfshihemi në aktivitete të rregullta ditore. Konvikt i përmban fushat sportive, vendet për të mësuar, kinema dhe shumë vende të tjera për aktivitete nga më të ndryshmet. Pa dyshim, ky konvikt është përvoja më e mirë në jetën time.

Jeta në konvikt Kolos Kabashi - X d



Në fillim mendoja se do të ishte krejt ndryshe. E paramendoja më të vështirë dhe kurrë nuk e kisha menduar se do të gjeja kaq shpejt kaq shumë shokë të mirë, që do të qeshja aq shumë dhe të më dilnin lot nga e qeshura.

Kjo jetë po më pëlqen shumë, sepse është me shumë rregull dhe shumë disiplinë. Kjo është ajo që do të më bëjë më dinamik për jetë dhe këta njerëz së shpejti do t'i konsideroj familje. Shkolla, konvikt, mensa, sallat dhe të gjitha janë shumë në nivel.

Thënë të drejtën më merr malli për disa persona në shtëpi poashtu edhe në shoqëri, por ky mall më merr vetëm kur po thellohem në mendime, sepse njerëzit që kam pranë në këtë shkollë më bëjnë të harroj për mallin tim për shoqërinë e familjen dhe jam shumë mirënjohës dhe falënderoj zotin që më ka sjellë rreth vetes një shoqëri kaq të mirë. Poashtu sa i përket ushqimit është shumë në nivel. Edhe profesorët e edukatorët janë shumë të zgjedhur dhe të mirë.

Tani që kam filluar të përshtatem dhe të kem një rreth shumë më të madh të shoqërisë, dita- ditës po më pëlqen më shumë. Unë jam i sigurt se kujtimet më të mira të jetës do t'i kem këtu dhe e di që me problemet që po mërzitemi tani, më vonë do të qeshim. Poashtu dua të shtoj se sa i përket mësimi është ndër shkollat më të mira në Kosovë.

Internat

Jeta në konvikt Anita Gegaj - XI d




Të shkruash për jetën në konvikt është paksa e vështirë, sepse ka shumë gjëra që të bëjnë ta kuptosh jetën në shoqëri. Gjithçka është e programuar dhe mësimi është në nivel të lartë.

Së pari, për ata që banojnë në konvikt, ky vend bëhet si shtëpia e dytë e tyre. Gjithçka funksionon për mrekulli dhe gjithmonë jemi nën përkujdesjen e edukatorëve, të cilët janë të gatshëm në çdo kohë.

Jeta në konvikt të mëson shumë gjëra, të bën të aftë për jetë, të dallosh të bardhën nga e zeza etj. Por besoj se çdo individ i cili ka zgjedhur konviktin, ka bërë përzgjedhjen e duhur, duke e analizuar jetën këtu në të gjitha dimensionet, sepse çdo fillim i ri ka veçantitë e veta.

Jeta në konvikt Veronika Gjergjaj - VI a



Kur erdha në këtë shkollë më pëlqeu shumë që në fillim. U befasova për çdo gjë që pashë aty. Çdo gjë ishte në vendin e vet, e pastër dhe e rregullt. Kur hyra në konvikt u binda menjëherë se ishte shumë bukur.


Aty kishte dhoma dhe gjithçka tjetër. Kjo shkollë quhet Loyola-Gymnasium në të cilin ka shumë gjelbërim.

Konvikti është i bukur dhe me kushte shumë të mira, te i cili kam gjetur një shoqëri të shkëlqyeshme. Edukatorja ime është motra Hildë. Unë u befasova në shumë gjëra: me kushtet që i ofron, me rregullin, pastërtinë etj. Fillimi qe shumë i bukur, por unë nuk kam besuar që do të jetë kaq mirë. Tani ndihem shumë mirë dhe jam shumë e lumtur. Në shkollë ka edukatorë e arsimtarë të zellshëm etj. Kurse drejtori i kësaj shkolle, Walter Happel është i shkëlqyeshëm. Për mua, kjo shkollë është më e bukur dhe më e mira nga të gjitha. Unë në shkollë mësoj shumë, sidomos me shoqet e mia. Në konvikt shoqet më duan shumë, por edhe unë i dua shumë.

Mirëpo, më së shumti e dua motrën Hildë.

Konvikt

Konvikti është shtëpia ime e dytë Egzon Heqimi - XI e



Të mendosh se do të jetosh brenda një bote të kufizuar, ku për çdo gjë ka rregulla dhe thyerja e tyre ndëshkohet, është diçka që në fillim të duket e vështirë. Edhe unë në fillim kisha këtë ndjenjë, derisa hyra në këtë botë. Por, këtu është vendi ku çdo gjë bëhet bashkë dhe ndahet me njëri-tjetrin, si hidhërimet, gëzimet, dashuritë e një adoleshenti. Në këtë mënyrë bëhemi një familje e madhe, anipse në fillim nuk njiheshim, por tashmë interesat e mirëkuptimi na mundësojnë që të jemi më afër njëri-tjetrit.

Gjithçka fillon me lindjen e diellit, ku rrezet e tij depërtojnë në çdo dritare, për të lajmëruar se dita filloi, por me të edhe jeta në konvikt. Të gjitha korridoret janë të mbushura nga shokët të cilët bëhen gati për mësim, gjithçka fillon të ngadalësohet e të zbrazet, kur zilha bie për të filluar mësimi. Kështu ne presim deri në orën e gjashtë, ku pastaj të gjithë vrapojmë për të marrë ngrohtësinë e konviktit e të relaksohemi nga stresi. Janë dhomat e përbashkëta ku i kalojmë kohën dhe zgjidhim problemet tona, së bashku me edukatorin.

Kohën e lirë e kalojmë në oborrin e shkollës, në fushat sportive, duke luajtur me njëri-tjetrin, apo duke shëtitur me shokët. Gjatë orëve të mësimi i bëjmë detyrat dhe bëhemi gati për ditën e nesërme, sepse rrezet e diellit tash po na përshëndesin. Vjen edhe koha e ushqimit, ku gjëja e parë që kujtojmë është rreshti i gjatë për të marrë ushqim, por edhe kjo kalon shpejt.

Me kalimin e rrezeve të diellit, largohet edhe ajo energji e jona përplot me aktivitete dhe kështu koha e gjumit afrohet dhe gjithçka mbaron, kur ne pushojmë në dhomë, ku çlodhemi e gjejmë qetësi.

Kjo me pak fjalë është jeta në konviktin tonë, ku mund të pavarësohesh dhe ta njohësh veten më mirë se kurrë.

Internat

Ekskursioni në Pejë, Deçan dhe Junik Shqipdona Janova - X d



nim edhe me njerëz të vendeve të huaja.

Në autobus u shoqëruam me shpjegimet e vendeve të ndryshme në të cilat do të ndaleshim, shkuam në portën perëndimore të Pejës, vizituam kulla të ndryshme antike që i përkisnin familjeve të pasura, vizituam bibliotekën dhe në fund vendosëm të shkonim në manastir, i cili ndodhej në Deçan, ku murgjit na shpjeguan kohën dhe mënyrën se si ishte ndërtuar kisha. Ciceronët vazhdimisht përkthenin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Pra, kishim kaluar një ditë të paharrueshme, duke parë vende, duke qeshur me njëri-tjetrin. Hijeshinë e udhëtimit ia shtoi muzika dhe këngët që i kënduam në tren gjatë tërë kohës, e mbi të gjitha, kur në fund na kërkuan plotësimin e disa formularëve për mënyrën se si kishim kaluar në këto tri qytete. Ishte ndjenjë mjaft e bukur, sepse të bënte të mendoje se gjendesh në një vend të zhvilluar evropian.

Pushimet verore kishin mbaruar, tashmë filloi viti i ri shkollor e pas dy javësh mësimi, edukatorët na mblodhën në një sallë, vetëm klasat e njëmbëdhjeta dhe na lajmëruan se ne ishim pjesë e një organizimi për shëtitje me tren në Pejë, Deçan dhe Junik. Kjo shëtitje do të organizohej ditën e diel dhe ne në fakt mezi e prisnim. Kështu erdhi dita e diel, vajzat ishin zgjuar shumë herët për t'u përgatitur. Autobusi erdhi dhe hipëm me vrap. Me autobus shkuam deri në Prishtinë, pastaj kur mbërritëm, filluam të hipnim në tren, për të udhëtuar deri në Pejë. Pas pak punonjësit na sollën biletat dhe disa fletushka në të cilat tregohej programi i tërë ditës, ku do të shkonim, ku do të ndaleshim e gjëra të tilla. Pastaj kur mbërritem në Pejë, aty po na priste autobusi dhe ciceroni i cili do të na tregonte vendet me të veçanta të këtyre qyteteve. Ishte me të vërtetë një ndjenjë shumë e këndshme, se përveç që po udhëtonim me shokët dhe shoqet, ne do të udhëtonim

Konvikt

Një ditë në errësirë Kastrati Ledjana - XI e



Shpeshherë mendojmë se askush nuk mendon për ne, se të gjithë na kanë braktisur në këtë luftë për ekzistencë dhe i harrojmë ata që na duan. Mendojmë se ata që i njohëm dhe, janë ata që na duan, e i harrojmë më të rëndësishmit-ata që vërtet na duan. Ka momente në jetë kur ndihesh sikur nuk i përket kësaj bote. Zgjahemi në mëngjes dhe vjen një moment kur diçka të bën të lumtur dhe ajo gjë, sadopak e vogël që të jetë, të bën të ndihesh e vlefshme përsëri. Por, kujdes!

Ka ditë kur një gjë tejte e vogël të bën të ndihesh se je pjesë e asaj që quhet jetë. Jeta është shumë e shkurtër, por përplot me sfida. Në jetë bëjmë edhe gabime. Epo, gabimet janë njerëzore. Nuk duhet të dorëzohemi për një gabim të vogël, sepse jeta të jep një mijë mundësi për t'u përmirësuar. Nëse je gjithmonë i mërzitur dhe ndjehesh i braktisur nga bota, kapu për diçka, për

një fije shprese. Ajo fije do të të mbajë shumë gjatë, sa nuk mund ta marrësh dot me mend. Mos u dorëzo, provo gjëra të reja. Rreziko ndonjëherë, sepse askujt lumturia nuk i servohet në pjatë. Jetoje jetën në maksimum dhe ata të cilët të kanë keqtrajtuar dhe nënvlerësuar gjithmonë, ata që të thoshin se nuk do të arrish asgjë në jetë, ata vetëm shikojnë nga lart dhe qesh. Nuk thonë kot: "Qesh mirë ai, që qesh i fundit." Mos u mërzit kur të mbyllet një derë, sepse në ato çaste hapen shumë dyer të tjera, mjafton që ti të kesh dëshirë, të besosh dhe të shpresosh.

Kurrë mos thuaj nuk mundem, por thuaj "do të provoj", sepse ekziston gjithmonë shpresa për diçka më të mirë. Ekziston gjithmonë një ditë në errësirë.



Internat

Fillimi i jetës si gjimnaziste Agita Krasniqi - X c



Noshta është pakëz herët për të arritur në përfundime për jetën në konvikt, por në mendje më sillet një shprehje e babait, kur thoshte: Ditët e para në konvikt do të duken ndoshta më të gjata, sesa vitet tjera që do t'i kalosh aty. E thoshte këtë shprehje, sigurisht nga përvoja e tij si mërgimtar.

Një shoqëri e re, krejtësisht e panjohur për mua, që të ngjan në një komponim kimik, rezultatin apo formulën do ta zbulosh vetëm pas ca vitesh, apo nuk do të arrish ta kuptosh kurrë, në një matematikë që në fund do të marrë shumë gjyime të sakta, apo edhe të pasakta. Megjithatë, njeriu në jetën e tij çdo ditë e fillon me një synim, dhe synimi im ishte të vija këtu, me arsyen e vetme se kryefjala e kësaj shkolle është "dituria" dhe kallëzuesi është "respekti i të qenit njeri", pa dallim ngjyre, feje, apo kombi që në krahurën e sotme të krijuar nga vetë qenia njeri nuk

mund t'i gjesh çdokund në botë.

Tanimë jam bërë pjesë e këtij synimi dhe lirshëm mund të them, se këtu kam gjetur motrat, vëllezërit dhe prindërit e mi që i lash në shtëpi. Gjeta shoqet me të cilat ndaj së bashku çdo çast të lumtur, apo të hidhur dhe ndjehemi sikur të ishim një; me ato me të cilat edhe ëndërrat gjatë natës së bashu na shtjellohen. Gjeta edhe mëmën time të dytë, edukatoren e cila ngjan në një engjell të dëguar nga Krijuesi veçanërisht për ne. Edukatoren që shpeshherë bëhet vetë loti ynë gjatë dhembjeve shpirtërore apo fizike, mbase loti lehtëson çdo dhembje. Pse mos ta quaj shqiponjë, mbase kush mund ta ruaj më me fanatizëm folenë e saj, sesa një shqiponjë? Kush është më besnike dhe më e ngrohtë për të vegjëlit e saj sesa një shqiponjë? Ngrohtësia, dashuria dhe forca që na jep edukatorja, janë shpesh dhe kurajo për të ardhmen tonë, që shpresoj se do të shndris dhe jo kot e quaj engjell!

Çfarë më mbetet tjetë të them?

Mbase fjalët janë të pafundme dhe mund të them shumë, por ia lë kohës të thotë edhe ajo fjalët e saj, do të mundohem që një ditë, çdo sacrificë ta shndërroj në sukses, mbase ky do të jetë shpërblimi më i vlefshëm që mund ta bëj për shkollën time "Loyola", për edukatoren, për profesorët e mi dhe për vetë jetën time.

Shpresoj se do të ndihen krenarë me mua në të adhmën.



Konvikt

Vendi i realizimit të ëndrrave Bletina Krasniqi - X c



Jeta ka shumë peripeci, sakrifica e mundime të lodhshme. Asnjëherë nuk mund ta imagjinosh atë që është duke të pritur, atë që jeta ka përgatitur për ty. Ndonjëherë gjithçka ndryshon.

Ndjenja të çuditshme, në situata të ndryshme. Frika e kalimit të testit ishte shumë larg mërzitjes që përjetova atë ditë kur erdha në konvikt. Këtë mërzi nuk e kisha imagjinuar kurrë; ishte si një det i furishëm, dallgët e të cilit binin mbi mua dhe më goditnin aq fuqishëm, sa që nuk mund të dilja prej tyre.

Jam një person jashtëzakonisht i ndjeshëm. Ndarja nga familja që pika ime më e dobët. Më besoni, se kurrë nuk mund ta imagjinoja këtë ndarje, këtë përjetim. Mirëpo ditët kaluan shumë shpejt dhe ai moment erdhi. Tashme ndodhesha para një porte të madhe dhe prisja të hapej, prapa së cilës do të lija valixhe të shumta kujtimesh dhe përjetimesh. Ajo portë u hap dhe unë hyra në të e vetme, mirëpo e rrethuar nga ëndrra, synime dhe dëshira. Tashmë filloi realizimi i tyre. Ne kishim marrë mbi vete përgjegjësi të mëdha. Pra, nuk isha vetëm unë, kishte edhe shumë vajza të tjera me ndjenja të njëjta, por pika ku ne mbështetemi është edukatorja. Ajo tashmë është prindi ynë, ndihma jonë dhe krahu ynë i djathtë. Është ajo e cila sakrifikon për ne, lufton për ne dhe ajo e cila na përgatit për një të ardhme më të ndritshme. Janë, gjithashtu, edhe shoqet e mia, ato me të cilat qeshim, luajmë, bashkëpunojmë, argëtohem, por, me të cilat ndajmë edhe mërzinë.

Ajo që mendoja unë, doli të jetë plotësisht më ndryshe. Ne, tashmë jemi ambientuar dhe konvikti është shtëpia jonë, vendi ku zhvillohen ngjarjet më të rëndësishme dhe më interesante të jetës sonë. Prandaj, nuk jam penduar asnjëherë për zgjedhjen që të jem pjesë e kësaj shkolle madhështore. Mbase është vendimi më i mirë që kam marrë ndonjëherë, sepse Loyla- Gymnasium është vendi i realizimit të ëndrrave.

Ajo që mendoja unë, doli të jetë plotësisht më ndryshe. Ne, tashmë jemi ambientuar dhe konvikti është shtëpia jonë, vendi ku zhvillohen ngjarjet më të rëndësishme dhe më interesante të jetës sonë. Prandaj, nuk jam penduar asnjëherë për zgjedhjen që të jem pjesë e kësaj shkolle madhështore. Mbase është vendimi më i mirë që kam marrë ndonjëherë, sepse Loyla- Gymnasium është vendi i realizimit të ëndrrave.



Të jetosh Vjosa Krasniqi - XI e



Të jetosh

Kur dyert t'i mbyllin papritmas,
dhe e gjen veten në dobësi,
mos hiq dorë, mos u dorëzo,
kërko për veten një tjetër derë.

Kur shpresat t'i rrëmbejnë dhe ikin,
dhe mendon që s'ka më jetë,
prit dhe pak mos u lodh,
shpresa të reja kërko.

Kur ëndrrat do t'i shkelin rëndë,
mos vajto, as mos bëj zë,
se nuk të dëgjon askush,
por bjer në gjumë dhe prapë ëndërro.

Kur shpirtin ta rrëmbejnë,
dhe ndien dhimbje të mëdha,
ti prap duro dhe në këmbë qëndro,
dil kërko një tjetër shpirt.

Kur zemrën tënde ta përplasin,
dhe copëzat e saj nuk i gjen dot,
gjysmën tjetër, mos u ndal, kërkoje,
se shumë zemra ka kjo botë.

Dhe kur jetën ta shkatërrojnë,
ti sërish vazhdo buzëqesh,
kërko arsye për jetë,
arsye të vetme, shpresën ta kesh.

Shpresa vdes e fundit! Agita Krasniqi - X c



Shpresa vdes e fundit!

U lëndova ... por u ngrita.
U rrëzova ... por përsëri eca.
Qava ... por përsëri buzëqesha.
Bërtita ... por u qetësova.
U mërzita nga jeta ... por nuk e braktisa atë.
Besova ... u zhgënjeva ... por ende mundohem të besoj.
Erdhi nata, thashë do të vijë dita.
Erdhi fatkeqësia, thashë do të vijë edhe e mira.
Më është bërë shpirti akull, thashë do të vijë dielli.
Diçka më grinte brenda, thashë do të më largohet.
Nuk ndjehesha mirë, thashë do të më kalojë.
Plaga e hapur në shpirt më rridhte gjak, thashë do të ndalet.
Këmbët më dridheshin, thashë do të më pushojnë.
Mbytesha në lot, thashë përsëri do të buzëqeshi.
Binte shi, thashë do të dalë ylberi.
Rashë në grackë, thashë do të dal nga kjo.
Thashë, por a u bë?

Shpresa vazhdoi të jetonte edhe kur mendoja se ka vdekur.
Falë kësaj shprese unë jetoj dhe eci përpara.
Edhe ju thoni se shpresa më vdiq, por jo, edhe pse ndoshta ka humbur
ajo ekziston ende, nga vetë fakti se ti vazhdon të jetosh.

Kuptoje o njeri: "Shpresa vdes e fundit!"

Besucher & Besuche

Besucher in Prizren Unsere Besuche



18. – 22.09.2013
Die Vertreter der, an der Ausbildungsinitiative teilnehmenden Firmen, sind am Loyola-Gymnasium.



08.10.2013
Der Chef der EULEX Mission, Bernd Borchardt besucht das Loyola-Gymnasium.



P. W. Happel SJ nimmt an der Tagung der Militärseelsorge in Berlin teil.



P. W. Happel SJ & H. Schwarzbach nehmen an der Vorstandssitzung und der Mitgliederversammlung des Fördervereins teil.



12.10.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach auf der Geburtstagsfeier von Dr. Haberecht.



14.10.2013
P. W. Happel SJ hält einen Vortrag bei den Rotary Club in Beckum-Oelde.



06.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach treffen OStD W. Frontzek, StR J. Endres und StR S. Machan vom Friedrich-List-Gymnasium.



07.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach besuchen im Auswärtigen Amt, VLR Dr. T. Schmitt und LR Dr. K. Shimizu.



07.11.2013
P. W. Happel SJ & M. Werhahn-Röttgen & J. Schwarzbach nehmen am Festakt von Renovabis, in Berlin, teil.



08.11.2013
P. W. Happel SJ & M. Werhahn-Röttgen & J. Schwarzbach berichten Frau Chr. Böhl, Referentin von Frau Dr. M. Flachsbarth.



08.11.2013
P. W. Happel SJ & M. Werhahn-Röttgen & J. Schwarzbach besuchen Militärdekan, Msgr. Joachim Simon, in Berlin.



11.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach berichten bei der ZfA in Köln, dem Leiter J. Lauer und H. Heinrichsen.

Mysafirët & Vizitat

Mysafirët në Prizren Vizitat tona



11.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach besuchen Dr. R. Solzbacher, Leiter der Diözesanstelle Weltkirche der Erzdiözese Köln.



12.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach treffen in Stuttgart den Präsidenten der Stellanervereinigung, Dr. J. Wollensak.



13.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach besuchen Familie Tilman, von der Friedrich Dütting Stiftung, in Freiburg.



14.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach besuchen Dr. Cl. Stroppe, Generalvikar der Diözese Rottenburg-Stuttgart.



15.11.2013
P. W. Happel SJ & J. Schwarzbach besuchen Renovabis in Freising und sprechen mit Dr. G. Albert und Herrn H. Schedler.



10.-30.11.2013
Prof. Alban Gashi hospitiert am Thomas-Morus-Gymnasium in Oelde.

Besucher & Besuche

Besucher in Prizren Unsere Besuche




14.12.2013
Das Netzwerk der Frauen Kosovos ist zu Gast und feiern mit über 80 Jugendlichen ein Sportfest.



27.01.2014
P. W. Happel SJ besucht den Rotary Club Beckum-Oelde.



09.01.2014
P. W. Happel SJ trifft Ehemalige in Oelde, die im Münsterland eine Ausbildung machen.



27.01.2014
P. W. Happel SJ & P. Bala besuchten den Außenminister Kosovos, Dr. E. Hoxhaj, in Pristina.



30.01.2014
P. W. Happel SJ besucht die Kultur- und Pressereferentin der Deutschen Botschaft in Pristina, Frau M. Tutsch.



07.02.2014
M. Werhahn-Röttgen nimmt an der Mitgliederversammlung des ASB Neustadt teil.



03.04.2014
Schüler und Lehrer des Loyola-Gymnasiums sind beim Sender RTV 21, in Prizren, eingeladen.



05.04.2014
Declan Murphy, Aid to the Church in Central and Eastern Europe der U.S. Conf. of Catholic Bishops, besucht das Loyola-Gymnasium.



05.-12.04.2014
Schüleraustausch – Schüler des Friedrich-List-Gymnasiums in Gemünden sind zu Besuch in Prizren.



05.-12.04.2014
Schüleraustausch - 15 Schüler besuchen das Gymnasium Blankenese in Hamburg.



15.04.2014
Die Mitglieder des Trägervereins treffen sich zur 21. Sitzung am Loyola-Gymnasium.



16.04.2014
Dr. R. Solzbacher und Frau S. Preiss besuchen das Loyola-Gymnasium.

Mysafirët & Vizitat

Mysafirët në Prizren Vizitat tona



16.04.2014
Frau M. Tutsch besucht das Loyola-Gymnasium.



16.04.2014
Oberst Josef Jünemann besucht das Loyola-Gymnasium.



07.05.2014
Madame Maryse Daviet, die französische Botschafterin im Kosovo, besucht das Loyola-Gymnasium und referiert vor Schülern.



24.-31.05.2014
Schüleraustausch – Unsere Schüler besuchen das Friedrich-List-Gymnasiums in Gemünden.



28.05.-04.06.2014
2 Schüler nehmen, auf Einladung des ASB, am Europamarathon in Görlitz teil.



03.06.2014
Schüler zu Besuch bei der Caritas Prizren.

Besucher in Prizren Unsere Besuche



05.06.2014
Vertreterinnen des Deutsch-
lehrerverbandes Westbalkan
besuchen das Loyola-Gym-
nasium.



10.-21.06.2014
P. P. Leutenstorfer SJ besucht
das Loyola-Gymnasium.



07.-25.07.2014
Prof. Isme Hoxha nimmt an
einem Seminar für Ortslehr-
kräfte an Sprachdiplomschu-
len, in Köln und Bovenden,
teil.



30.09.2014
Oberst von Keyserlingk,
Kommandeur des deutschen
Kontingents der KFOR,
besucht das Loyola-Gymna-
sium.



Der Förderverein (AG Münster – VR 70758)

ist zur ideellen und materiellen Unterstützung der Association "Loyola-Gymnasium" am 22. März 2007 als eingetragener Verein gegründet worden. Er soll darüber hinaus den Schüleraustausch zwischen dem Gymnasium in Prizren und deutschen Schulen vermitteln und fördern. Diese Vereinszwecke werden durch Mitgliedsbeiträge und Spenden realisiert.

Spendenkonto

Bank Volksbank Beckum-Lippstadt eG
Kontonummer 103162600
BLZ 41660124
IBAN DE96 4166 0124 0103 1625 00
BIC/SWIFT GENODEM1LPS

Bitte geben Sie im Verwendungszweck Ihren Namen und Ihre Anschrift an. Nur dann können wir Ihnen eine steuerlich anerkannte Spendenbescheinigung zusenden. Der Versand erfolgt automatisch im Januar des Folgejahres.

Anschrift

Holtmar 13
D - 59269 Beckum

Telefon

+49 (0) 2521 58 51
+49 (0) 8151 911 700

E-Mail/URL

verein@alg-prizren.com
www.alg-prizren.com

Vorstand

Dirk Komitsch
Finanzen
Michael Werhahn-Röttgen
Vorsitzender
Peter Tiggesbäumker
Schriftführer
Jürgen Schwarzbach
Stv. Vorsitzender

**Meine persönlichen Daten:**

Name, Vorname*

Firma

Straße*

Land/PLZ/Ort*

Telefon

E-Mail**

SEPA-Lastschriftmandat
(nur innerhalb des einheitlichen EURO-Zahlungsverkehrsraumes möglich):

Ich ermächtige die Freunde und Förderer der Association "Loyola-Gymnasium", Zahlungen von meinem Konto mittels Lastschrift einzuziehen. Zugleich weise ich mein Kreditinstitut an, die von Freunden und Förderern der Association "Loyola-Gymnasium" auf mein Konto gezogenen Lastschriften einzulösen. Hinweis: Ich kann innerhalb von acht Wochen, beginnend mit dem Belastungsdatum, die Erstattung des belasteten Betrages verlangen. Es gelten dabei die mit meinem Kreditinstitut vereinbarten Bedingungen.
Gläubiger-Identifikationsnummer: DE18ZZZ00000179289
Mandatsreferenz: Mitgliedsnummer

Bank*

IBAN*

BIC/SWIFT*

Datum/Ort/Unterschrift*

* Felder müssen immer ausgefüllt werden!

** E-Mail-Adresse eintragen und zukünftig, kostenlos ALG News erhalten.

Durch meine Mitgliedschaft im Förderverein und/oder meine Spende unterstütze ich die Erziehungs- und Bildungsarbeit am Loyola-Gymnasium.

Ich spende!

Meine Spende beträgt:

_____ EUR
bitte eintragen

Ich werde Mitglied!

Mein jährlicher Mitgliedsbeitrag beträgt:

- ☐ 24 EUR
☐ 48 EUR
☐ 96 EUR

_____ EUR
bitte ankreuzen oder eintragen

Die Seite bitte ausfüllen, heraustrennen und per Post senden an:

Freunde und Förderer der Association "Loyola-Gymnasium" e. V.
Michael Werhahn-Röttgen
Holtmar 13
59269 Beckum
Deutschland

Spendenkonto

Jesuitenmission

Bank: Liga Bank
Vordere Sterngasse 32
90402 Nürnberg - Deutschland

Kontoinhaber: Jesuitenmission
Königstr. 54
90402 Nürnberg - Deutschland

Kontonummer: 5115582
BLZ: 75090300
IBAN: DE61 7509 0300 0005 1155 82
BIC/SWIFT: GENODEF1M05
Stichwort: Loyola-Gymnasium Prizren

Zuwendungsbescheinigungen werden erstellt.

Kontoja e donacioneve

Förderverein

Bank: Volksbank Beckum-Lippstadt eG
Südstraße 15
59269 Beckum - Deutschland

Kontoinhaber: Freunde u. Förderer der ALG e.V.
Holtmar 13
59269 Beckum - Deutschland

Kontonummer: 103162600
BLZ: 41660124
IBAN: DE96 4166 0124 0103 1626 00
BIC/SWIFT: GENODEM1LPS

Zuwendungsbescheinigungen werden erstellt.



www.alg-prizren.com

